

## **Analizë e diskursit ekstremist fetar në media**



# **Analizë e diskursit ekstremist fetar në media**



*Tiranë 2016*



## Embassy of the United States of America Tirana, Albania

Ky botim mbështetet financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë dosmosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

### ***Analizë e diskursit ekstremist fetar në media***

*Punoi:* Rrapo Zguri

*Intervistoi:* Laert Miraku

*Monitoroi:* Kujtim Xhaja

*Botues:*



**Albanian Media Institute  
Instituti Shqiptar i Medias**

Rr. Gjin Bue Shpata, nr.8, Tiranë, Shqipëri

*Tel/Fax:* +42229800

*E-mail:* [info@institutemedia.org](mailto:info@institutemedia.org)

[www.institutemedia.org](http://www.institutemedia.org)

© Instituti Shqiptar i Medias 2016

## Treguesi i lëndës

1. Terminologji dhe qasje konceptuale .....	10
2. Konteksti historik fetar në Shqipëri .....	17
3. Mbi praninë dhe shkallën e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri .....	21
4. Metodologji dhe instrumente të matjes së ekstremizmit fetar në media .....	29
5. Diskursi ekstremist fetar në mediat shqiptare – qasje sasiore .....	39
6. Diskursi ekstremist fetar në mediat shqiptare – qasje cilësore .....	45
<i>Identiteti fetar përkundër identitetit kombëtar .....</i>	<i>46</i>
<i>Toleranca fetare dhe “leximi tjetër për tjetër “ i saj .....</i>	<i>52</i>
<i>Feja Islame në tranzicion - Salafi në vend të Hanefi? .....</i>	<i>56</i>
<i>Sheriati apo shteti ligjor i demokracisë liberale? Kalifati në horizont... ..</i>	<i>62</i>
<i>Diskursi antiperëndimor e antiamerikan dhe teza e standardeve të dyfishta .....</i>	<i>69</i>
<i>In extremis – Përligjja, glorifikimi dhe promovimi i dhunës ekstreme .....</i>	<i>75</i>
7. Përmbledhje ekzekutive .....	80
Literatura .....	91



**G**jatë viteve të fundit në axhendën e mediave të Shqipërisë kanë qenë gjithnjë e më të pranishme lajmet, komentet apo materialet e tjera informative mbi zhvillimet që lidhen me dukuri të tilla si ekstremizmi, radikalizmi apo fundamentalizmi fetar. Një prani e shtuar e kësaj lloj përmbajtjeje në mediat kryesore apo në mediat online është vënë re sidomos pas akteve terroriste në Paris, në janar dhe nëntor të vitit 2015, dhe në vijimësi në momentet e raportimeve për ngjarje dhe zhvillime të bujshme apo tragjike që lidhen me të ashtuquajturën “luftë të shenjtë” të ISIS në Siri dhe Irak, në frontin e së cilës gjenden sot edhe një numër relativisht i konsiderueshëm mercenarësh nga Shqipëria dhe nga trevat e tjera të banuara nga shqiptarët.

Por pavarësisht nga kjo prani e shtuar e kësaj lloj përmbajtjeje në media, në Shqipëri ende nuk është realizuar ndonjë punë kërkimore-studimore rreth saj. Analizat dhe studimet e deritanishme ishin fokusuar kryesisht në aspekte si gjuha e urrejtjes ndaj minoriteteve etnike apo ndaj grupeve të marginalizuara, etj. Ndërsa studimet dhe kërkimi për ekstremizmin fetar në diskursin e medias pothuajse mungojnë. Duke patur parasysh këtë mungesë, u propozua ndërmarrja e këtij studimi, i cili synon të vëzhgojë dhe analizojë dukurinë duke u përpjekur

të aplikojë instrumente dhe indikatorë të matshëm të kërkimit empirik që lehtësojnë analizën dhe arritjen e përfundimeve më të bazuara dhe më të verifikueshme.

Duhet thënë se ekstremizmi nuk është një dukuri e re për Shqipërinë. Dhe nuk ka qenë i asociuar vetëm me fenë. Në rreth gjysmë shekulli diktaturë pas Luftës së Dytë Botërore, vendi njohu një nga një nga format më ekstreme të zbatimit të komunizmit si praktikë dhe si ideologji. Nën efektin post-traumatik të trashëgimisë komuniste, forma të tjera të ekstremizmit, si për shembull ekstremizmi politik, i shoqëruar jo rrallë me shfaqje protestash politike të dhunshme kanë qenë të pranishme edhe gjatë gjithë periudhës së tranzicionit. Në këtë lloj ekstremizmi, si dhe në përgjithësi në komunikimin politik të ashpër dhe të ngarkuar me dhunë verbale në këtë periudhë, një lloj roli ka patur edhe një tipar i vijueshëm specifik i elitave drejtuese të vendit: gjuha e ashper perjashtuese, e kultivuar prej kohësh si filozofi e kontrollit dhe e ushtrimit të pushtetit informal apo formal, në nivel lokal apo qendror.

Krahas ekstremizmit politik, gjatë viteve të tranzicionit ka lindur edhe një lloj ekstremizmi i ri i me bazë fenë apo manipulimin e saj. Objekt dhe subjekt i këtij ekstremizmi në Shqipëri ka qenë kryesisht feja Islame. Ai është shfaqur si një prirje për të radikalizuar besimin fetar Islam, duke përhapur disa shkolla apo doktrina konservatore të interpretimit të Islamit, siç janë salafizmi dhe vehabizmi, të cilat shfaqin një shkallë më të lartë puritanizmi dhe intolerance në krahasim me traditën hanefi të islamit shqiptar. Ky radikalizim është zhvilluar më së shumti përmes ligjërimit në disa xhami të vendit si dhe përmes një literature të gjerë të shtypur apo online. Por përtej ligjërimit, disa zhvillime tepër shqetësuese dhe serioze, si



rekrutimi dhe pjesëmarrja e një numri qytetarësh shqiptarë në radhët e ISIS si dhe implikimi i disa predikuesve të fesë islame në këtë proces, përveçse kanë verifikuar procesin e radikalizimit, kanë nxjerrë në dritë edhe një herë praninë e ekstremizmit të dhunshëm në vend.

Duke shqyrtuar këtë situatë, ky studim merr përsipër të paraqesë sfondin e lindjes dhe të zhvillimit të ekstremizmit fetar në Shqipëri, si dhe të hulumtojë dhe të analizojë format e shfaqjes së diskursit ekstremist fetar në median e shtypur dhe në mediat online.

## 1. Terminologji dhe qasje konceptuale

Termi “ekstremizëm” është një term gjerësisht i debatuar dhe përpjekje të ndryshme për përkufizimin e tij nuk i kanë shpëtuar kontestimit. Sipas Alex Schmid, kemi të bëjmë me një koncept relacional dhe për t’iu përgjigjur pyetjes “çfarë është ekstreme” do të duhet një pikë referimi, diçka që është (më) “e zakonshme”, “qendrore”, “mainstream” apo “normale” kur krahasohet me skajin politik (ekstrem).<sup>1</sup> Peter Coleman dhe Andrea Bartoli nga ana e tyre e përshkruajnë ekstremizmin si “...aktivitete (besime, sjellje, ndjenja, veprime, strategji) me karakter të distancuar nga e zakonshmja”<sup>2</sup>.

Siç shihet, përcaktimi i pikës së referimit prej nga nisemi për të identifikuar ekstremet është një moment kyç për sendërtimin e konceptit “ekstremizëm”. Pikënisjet nga kultura, ideologji apo epoka të ndryshme, mund të prodhojnë përkufizime të ndryshme, në disa raste

---

<sup>1</sup> Schmid, Alex P., *Violent and Non-Violent Extremism: Two Sides of the Same Coin?*, ICCT Research Paper, May 2014

<sup>2</sup> Coleman, Peter T. and Bartoli, Andrea, *Addressing Extremism*, White Paper. New York: The International Center for Cooperation and Conflict Resolution, Columbia University, f. 1

diametralisht të kundërta. Kështu, ajo që është “ekstrem” në një kulturë, ideologji, apo epokë mund të jetë “qendrore” në një kulturë, ideologji apo epokë tjetër.

Është diçka e ngjashme me përkufizimin e dhunës, e cila, sipas Alan Fiske dhe Tage Rai, “në një kulturë apo në një epokë historike mund të jetë morale, kurse në një kulturë apo epokë tjetër historike mund të jetë imorale”<sup>3</sup>. Orhan Pamuk e ilustron në mënyrë kuptimplotë këtë relativizëm të gjërave. “Ajo që në vitin 1453 në Lindje festohej si pushtimi i Stambollit, në Perëndim vajtohej si rënia e Kostandinopojës”<sup>4</sup>, shkruan ai.

Në kushtet e këtij relativizmi, është e domosdoshme të shprehemi qartë lidhur me pikën e referimit të përdorur në këndvështrimin dhe analizën e këtij studimi për dukurinë e quajtur ekstremizëm. Alex Schmid thekson se ekstremizmi mund të përcaktohet vetëm duke patur një pikë referimi, dhe në situatat aktuale kjo pikë referimi është modeli kushtetues liberal-demokratik i shoqërive perëndimore.<sup>5</sup> Pikërisht ky model dhe në tërësi sistemi i vlerave perëndimore ka shërbyer si pikë referimi edhe për këtë studim. Shqipëria tashmë ka adoptuar modelin shoqëror liberal-demokratik perëndimor, dhe është e natyrshme që ky model, i mbështetur masivisht nga shqiptarët, të përzgjidhet si pikë referimi. Por si një pikë e rëndësishme referimi do të shërbejë edhe sistemi

---

<sup>3</sup> Fiske, A.P. & Rai, R. S. (2015) *Virtuous Violence: Hurting and Killing to Create, Sustain, End and Honor Social Relationships*, Cambridge: CUP, f. 141.

<sup>4</sup> Pamuk, O. (2005) *Istanbul: Memories and the City*, London: Faber & Faber, p.156

<sup>5</sup> Schmid, Alex P., *Violent and Non-Violent Extremism: Two Sides of the Same Coin?*, ICCT Research Paper, May 2014

specifik i vlerave të shoqërisë shqiptare, siç janë toleranca ndërfetare, përparësia e identitetit kombëtar ndaj identiteteve të tjera, respektimi i traditës, etj.

Duke folur për ekstremizmin fetar, studiuesit perëndimorë ofrojnë një numër indikatorësh konkretë për identifikimin e tij. Kështu, Charles Kimball identifikon pesë shenja paralajmëruese të ekstremizmit fetar, të cilat nuk aplikohen ekskluzivisht vetëm tek individët, por në disa raste mund të jenë të aplikueshme edhe në një grup të tërë apo në një regjim teokratik. Këto shenja sipas tij janë:

1. Pretendimi për të vërtetën absolute
2. Bindja e verbër
3. Krijimi i kohës “ideale”
4. Teza “qëllimi përlijç çdo mjet”
5. Deklarimi i luftës së shenjtë<sup>6</sup>

Në shumë raste, si në diskursin global edhe në atë shqiptar, termi ekstremizëm përdoret në bashkëlidhje ose në vend të termit radikalizëm. Por cili është dallimi ndërmjet radikalizmit dhe ekstremizmit? Sipas Schmid, “një dallim më i saktë mes ekstremizmit dhe radikalizmit mund të arrihet duke iu referuar historisë së ideve në lidhje me këta terma. Nga ky këndvështrim, ekstremistët kanë prirjen të jenë supremacistë mendjembyllur kurse radikalët kanë prirjen të jenë egalitarinë (barazitistë - shënim i autorit) mendjehapur”<sup>7</sup>. Teologu shqiptar Ermir Gjinishi ofron një këndvështrim të ndryshëm në këtë

---

<sup>6</sup> Kimball, Charles, *When Religion Becomes Evil: Five Warning Signs*, (New York: Harper, 2002), kapitujt 2-6 (The Five Warning Signs of Corruption in Religion).

<sup>7</sup> Schmid, Alex P., *Violent and Non-Violent Extremism: Two Sides of the Same Coin?*, ICCT Research Paper, May 2014

debat: “Radikalizmi ka të bëjë me qëndrime strikte pa marrë parasysh, madje duke injoruar, kushtet e rrethanat specifike; ai është kryesisht ligjërim. Ekstremizmi është kapërcimi i kufirit dhe nga ligjërimi mund të kalojë në veprim”.<sup>8</sup>

Në një studim të ICCT (International Centre for Counter-terrorism – The Hague) theksohet se radikalët nuk janë në vetvete të dhunshëm. Ata mund kenë gjëra të përbashkëta me ekstremistët e dhunshëm, për shembull distancimin nga shteti, zemërimin ndaj politikës së jashtme, ndjenjat e diskriminimit, etj. Por ata kanë edhe ndryshime. Radikalët, për shembull, (të paktën ata të traditës politike europiane), dëshirojnë t’i shohin të gjithë njerëzit të barabartë, kurse ekstremistët, (jo vetëm në traditën politike europiane) priren të jenë autoritaristë.<sup>9</sup>

Ndërkohë nga institucionet e sigurisë në SHBA vjen një qasje që ofron plotësime të tjera. “Radikalizmi është procesi i adoptimit të sistemeve ekstremiste të të besuarit, përfshi edhe gatishmërinë për të përdorur, mbështetur apo lehtësuar dhunën si një metodë për të sjellë ndryshim shoqëror.”<sup>10</sup>

Një nga pikat më të nxehta të debatit teorik dhe të atij në media gjatë viteve të fundit ka qenë ajo e asociimit të fesë islame me dukuri të tilla si ekstremizmi, radikalizmi, fundamentalizmi apo terrorizmi. Shtimi pas këtyre termave të fundit i përcaktorit “islamik” gjatë ligjëritimit në media apo në komunikimin publik, (“ekstremizmi

---

<sup>8</sup> Intervistë me teologun Ermir Gjinishi në kuadër të këtij studimi. Intervistoi Laert Miraku

<sup>9</sup> Cituar në: Schmid, Alex P., *Violent and Non-Violent Extremism: Two Sides of the Same Coin?*, ICCT Research Paper, May 2014

<sup>10</sup> Përkufizim nga U.S. Department of Homeland Security

islamik”, “radikalizmi islamik”, “fondamentalizmi islamik” apo “terrorizmi islamik”) është kundërshtuar prej shumë teologëve, analistëve dhe studiuesve jo vetëm në Lindje, por edhe në Perëndim, pasi kjo pranëvendosje presupozon një lloj korrelacioni midis këtyre dukurive dhe Islamit si fe. Në situatën aktuale pyetjet kanë qenë konkrete: Ç’lidhje ka Islami me terrorizmin? A mund të akuzohet një besim fetar si burim dhe apo mbështetje ideore e ekstremizmit? A mund të jetë e dhunshme feja?

Shumë autorë perëndimorë, dhe jo vetëm, bëjnë dallimin mes “Islamit” si fe dhe “Islamit politik” si ideologji politike, e quajtur ndryshe “islamizëm”. Për Jeffrey Bale islamizmi është një variant supremacist që rrjedh kryesisht nga varianti politik i Islamit Suni. Ai është antisekular, antijobesimtar dhe antiperëndimor, duke kërkuar ndërtimin e një shteti (kalifati), tiparet puritane të të cilit duhet t’i përngjajnë situatës së Islamit të hershëm.<sup>11</sup>

Ghaffar Hussain dhe Erin Marie Saltman vënë shenjën e barazimit mes “Islamizmit” dhe “Ekstremizmit Islamist”. Sipas tyre ekstremizmi islamist/islamizmi burojnë nga këndvështrimi i Islamit si një ideologji politike totalitariste. Islamizmi proklamon se sovraniteti politik i përket Zotit dhe jo njerëzve. Islamistët besojnë se leximi i tyre i Sheriatit duhet të jetë ligji i shtetit, dhe se është detyrë fetare e të gjithë myslimanëve që të krijojnë dhe të zotohen për aleancë me një shtet Islamik që reflekton këto parime.<sup>12</sup>

---

<sup>11</sup> Bale, Jeffrey, *Denying the Link between Islamist Ideology and Jihadist Terrorism*, 2013, f.28

<sup>12</sup> Hussain, Ghaffar dhe Saltman, Erin Marie, *Jihad Trending: A Comprehensive Analysis of Online Extremism and How to Counter it*, Quilliam, May 2014, f. 6

Në një referim të vetin në Konferencën për Sigurinë në Mynih, më 5 shkurt 2011, kryeministri britanik David Cameron, duke folur për rolin dhe ndikimin e islamizmit në ndërmarrjen e disa prej akteve terroriste në Europë shprehet kthjelltazi lidhur me këtë debat:

“Ne duhet të shkojmë në rrënjët e problemit dhe duhet të jemi absolutisht të qartë lidhur me origjinën e këtyre sulmeve terroriste – dhe kjo është ekzistenca e një ideologjie, e “ekstremizmit islamist”. Ne duhet të jemi njësoj të qartë edhe lidhur me çfarë kuptojmë me këtë term dhe duhet të bëjmë dallimin mes tij dhe Islamit. Islami është një fe që ndiqet paqësisht dhe me devotshmëri nga mbi një miliard njerëz. Ekstremizmi islamist është një ideologji politike e mbështetur nga një minorancë. Në skajet fundore janë ata që mbështesin terrorizmin për të promovuar qëllimin e tyre final: krijimin e një mbretërie të tërë islamiste të qeverisur nga një interpretim i Sheriatit. Duke u zhvendosur përgjatë spektrit mund të gjejmë njerëz që e refuzojnë dhunën, por që pranojnë pjesë të ndryshme të botëkuptimit ekstremist, përfshi edhe një armiqësi reale kundrejt demokracisë perëndimore dhe vlerave liberale.... Ne duhet ta bëjmë të qartë. Ekstremizmi islamist dhe Islami nuk janë e njëjta gjë.”<sup>13</sup>

Në debatin global akademik, politik apo mediatik të dekadës së fundit pranohet gjerësisht se ekstremizmi islamist nuk është rrjedhojë e Islamit, por e keqinterpretimit dhe keqpërdorimit të tij për nevoja të interesave politike.

---

<sup>13</sup> <http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20130109092234/http://number10.gov.uk/news/pms-speech-at-munich-security-conference/>

Pikërisht këtë qasje konceptuale ndaj ekstremizmit islamist të shtjelluar më sipër vë në zbatim edhe ky studim. Dhe i qëndron kursit se “ekstremizmi islamist duhet të sfidohet dhe të përballohet, më shumë se sa të akomodohet apo të tolerohet nga demokracitë liberale.”<sup>14</sup>

Në rastin e përdorimit të termave relevantë në gjuhën shqipe, ia vlen të bëhet edhe një ftesë për shmangien e gabimit të përdorimit të përcaktorit “islamik” në vend të atij “islamist”. Në shqip fjala “islamik” përdoret si një formë mbiemërore e emrit Islam, për shembull në togfjalëshat “banka islamike”, “lidhja islamike”, “komuniteti islamik”, etj. Nga ana semantike, ky mbiemër lidhet drejtpërdrejt me Islamin si fe. Kurse përcaktori “islamist” semantikisht lidhet me ideologjinë politike, pra me islamizmin. Nën këtë optikë, është gabim jo vetëm gjuhësor por edhe konceptual përdorimi i mbiemrit “islamik” në togfjalësha si “ekstremizmi islamik” apo “terrorizmi islamik” dhe në vend të tij duhet përdorur përcaktori “islamist”; pra do të ishte më e saktë të thuhej “ekstremizmi islamist” apo “terrorizmi islamist”.

---

<sup>14</sup> Schmid, Alex P., *Violent and Non-Violent Extremism: Two Sides of the Same Coin?*, ICCT Research Paper, May 2014



## **2. Konteksti historik fetar në Shqipëri**

Historikisht Shqipëria ka qenë një vend multifetar. Pas ndarjes së Perandorisë romake në atë të Perëndimit dhe të Lindjes, gjysma e vendit mbeti nën Perandorinë e perëndimit, kurse gjysma tjetër mbeti nën Bizant. Kjo gjeti pasqyrim edhe në strukturën fetare: Veriu adoptoi fenë e krishterë katolike, kurse jugu fenë e krishterë ortodokse, duke nxjerrë në pah edhe rolin e pushtimeve të huaja në konfigurimin fetar të vendit. Pushtimi osman në shekullin e 15-të dhe zgjatja e tij për rreth pesë shekuj solli konvertimin e një pjese të madhe të popullsisë në fenë islame. Aktualisht në vend janë të pranishme katër besime fetare kryesore: besimi mysliman sunit, besimi i krishterë ortodoks, besimi i krishterë katolik dhe besimi mysliman bektashi. Por një përhapje të vogël kanë patur gjatë viteve të tranzicionit edhe fe apo fraksione fetare si evangjelistët, dëshmitarët e Jehovait, bahaistët, etj.

Statistikat për strukturën fetare të popullsisë kanë përsëritur deri vonë rezultate të njëjta me rezultatet e censusit të vitit 1938, sipas të cilit rezultonte se 70 përqind e popullsisë i përkiste besimit mysliman (sunit

dhe bektashi), 20 përqind i përkiste besimit ortodoks dhe 10 përqind besimit katolik.<sup>15</sup> Këto shifra janë përcjellë dhe konsideruar deri vonë pa ndonjë lloj kontestimi, deri në momentin kur pas shumë dekadash në Shqipëri, në vitin 2011, organizohet i pari regjistrim i popullsisë që përfshinte edhe pyetjen për përkatësinë fetare, i cili ishte gjithashtu edhe i pari census i kontestuar nga pothuaj të gjitha komunitetet fetare. Ky census prodhoi këto rezultate:

Myslimanë – 56.70 %	e	popullsisë	banuese	në	Shqipëri
Katolikë – 10.03 %	“	“	“	“	“
Ortodoksë – 6.75 %	“	“	“	“	“
Bektashinj – 2.09 %	“	“	“	“	“

Këto shifra janë publikuar edhe Central Intelligence Agency e SHBA.<sup>16</sup>

Në rezultatet e censusit bie në sy një përqindje e madhe e atyre që preferojnë të mos përgjigjen (13.79 %) dhe një numër jo i vogël që e konsiderojnë veten besimtarë, por nuk duan të identifikojnë përkatësinë e tyre fetare (5.49 %).<sup>17</sup>

Natyra multifetare e Shqipërisë dhe specifika e bashkëjetesës së komuniteteve fetare kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e botës së letrave. Studiues apo udhëtarë të huaj që kanë vizituar Shqipërinë gjatë shekullit të kaluar dhe të tjerë që janë marrë me studimin e traditës fetare shqiptare, kanë nxjerrë në pah ekzistencën shekullore të një fryme të tolerancës fetare dhe përparësinë e identitetit kombëtar ndaj identitetit fetar. Edith Durham që vizitoi dhe

---

<sup>15</sup> Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom, 2008

<sup>16</sup> <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/al.html>

qëndroi gjatë në Shqipëri në fillim të shekullit të njëzetë, kur vendi ishte ende në pushtimin otoman, shkruan:

“Shqiptari është gjithnjë shqiptar. Serbi musliman dhe bullgari musliman e kanë të fshirë sensin e nacionalitetit si pasojë e pushtetit të Islamit. Me shqiptarin është ndryshe. Ai para së gjithash është shqiptar. Feja e tij vjen më pas.... Përballë armikut të përbashkët, i krishteri dhe muslimani bëhen një. Disa kombe janë shumë të dhënë pas fesë. Shqiptarët si racë janë nga të paktët që janë të lirë prej saj. Muhamedanizmi i tyre dhe kristianizmi i tyre nuk kanë shumë peshë tek ata...”<sup>18</sup>

Analiza e raportit komb/fe nxjerr në dritë “thelbin e nacionalizmit si identitet parësor i çdo shqiptari, pavarësisht nga besimi fetar. Për të mos kundërshtuar nacionalizmin, bashkësitë fetare dhe besimtarët i linin mënjane konfliktet dhe ktheheshin në unitetin e humbur.”<sup>19</sup>

Miranda Vickers e përforcon më tej këtë argument. “Historikisht shqiptarët janë i vetmi popull në Ballkan vetëdija nacionale e të cilëve nuk ka qenë e formësuar apo e identifikuar prej përkatësisë së tyre fetare. Në vend të kësaj, shqiptarët e kanë përcaktuar identitetin nacional të tyre përmes gjuhës.” Vickers e sheh këtë edhe si rezultat i ekzistencës së një forme tradicionale tolerante të Islamit të praktikuar nga shqiptarët.<sup>20</sup>

---

<sup>17</sup> [http://www.instat.gov.al/media/177354/main\\_results\\_population\\_and\\_housing\\_census\\_2011.pdf](http://www.instat.gov.al/media/177354/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf)

<sup>18</sup> Mary Edith Durham, *The Burden of Balkans*, London, E. Arnold, 1905, f. 203-204, 206. Link: <https://archive.org/details/burdenbalkans00durhgoog>

<sup>19</sup> Morocco dela Roka, Roberto, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, SHB Elena Gjika, Tiranë

<sup>20</sup> Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom, 2008

Tradita Hanefi e Islamit sunit shqiptar ka qenë e ngjizur me një frymë pranimi në vend të përjashtimit dhe me një mungesë apo zbehtësi të indikatorëve të supremacisë, antisekularizmit apo të totalitarizmit, që janë indikatorë të qartë të ekstremizmit fetar. Nga ana tjetër, sipas Roberto Moroco dela Roka, sinkretizmi fetar i bektashinjve, disa ngjashmëri të tyre me krishterimin, toleranca e tyre dashamirëse ndaj feve të tjera sipas parimit të ekzistencës së një perëndie të vetme të pranuar njësoj nga besimet më të ndryshme, kanë ndihmuar në një lidhje të bashkësive të ndryshme fetare të këtij vendi të vogël ballkanik.<sup>21</sup>

---

<sup>21</sup> Moroco dela Roka, Roberto, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, SHB Elena Gjika, Tiranë

### **3. Mbi praninë dhe shkallën e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri**

Edhe pse feja në Shqipëri, duke përfshirë të gjitha besimet, mund të vlerësohej si një nga qasjet religjioze më tolerante në botë, ndaj saj për rreth 50 vjet është ushtruar dhuna dhe intoleranca më e madhe e njohur ndonjëherë. Gjatë periudhës së komunizmit, feja mori një goditje ekstreme të paimagjinuar dhe të paparë në ndonjë vend tjetër. Shumica e objekteve fetare u shkatërruan, literatura fetare u dogj dhe predikuesit e fesë u vranë apo u burgosën, duke pretenduar lindjen në hartën e botës të të parit vend ateist. “Kemi pasur 1667 xhami deri në vitin 1967 dhe shpëtuan vetëm 20 apo 30 prej tyre, ato që u shpallën monumente kulture”, thotë Ermir Gjinishi.<sup>22</sup>

Si rrjedhim, në fillim të viteve 1990, pas rënies së diktaturës komuniste dhe rinjohjes së të drejtës së besimit fetar, vendi u gjend në kushtet e një mungese të madhe të infrastrukturës fizike dhe shpirtërore fetare. Mungonin

---

<sup>22</sup> Intervistë me teologun Ermir Gjinishi në kuadër të këtij studimi. Intervistoi Laert Miraku

objektet e kultit, mungonin predikuesit e fesë, mungonte literatura fetare dhe mbi të gjitha mungonin burimet financiare që do të duhet të sillnin praktikisht ringjalljen e fesë.

Një numër autorësh vendas dhe të huaj, kur analizojnë kushtet dhe faktorët që çuan në lindjen e orientimit islamist në Shqipëri, rendisin mes tyre edhe disa zhvillime të ndodhura gjatë viteve '90, që kanë ushtruar ndikim të tërthortë apo të drejtpërdrejtë në këtë proces. Kështu, një vendim i Presidentit të Republikës i dhjetorit 1992 për të kërkuar anëtarësim me të drejta të plota të Shqipërisë në Organizatën e Konferencës Islamike ishte një nga zhvillimet që solli, për herë të parë në axhendën publike, debatin mbi orientimin e vendit drejt një aleance ndërkombëtare me të cilën shqiptarët i afrojnë vetëm një element: elementi fetar.

“Vendimi u mor nxitimthi, pa konsultim me parlamentin dhe shumë shqiptarë u shqetësuan se mos kjo lëvizje do ta rreshtonte Shqipërinë në krah të botës islamike”,<sup>23</sup> shkruan Miranda Vickers. Vetëm disa muaj pasi shqiptarët kishin votuar “për ta bërë Shqipërinë si gjithë Europa”, siç ishte edhe slogani i protestave të studentëve kundër diktaturës, doli në skenë një propozim që e orientonte vendin - jo vetëm gjeografikisht - në drejtim të kundërt të Europës. Një shqetësim tjetër buronte edhe nga fakti se propozohej një aleancë apo vendimmarrje gjeo-politike e cila bazohej në kriterin e përkatësisë fetare.

“Kështu nisi përfshirja e Shqipërisë në botën Arabo-Islamike. Në muajt në vijim hapet në Tiranë Banka Islamike

---

<sup>23</sup> Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom, 2008

Arabo-Shqiptare dhe rreth 20 fondacione arabe islamike u themeluan në të gjithë vendin. Organizatat e huaja islamike nisën një program të ndërtimit të xhamive në çdo skaj të vendit dhe madje financonin edhe shpenzimet e atyre shqiptarëve që udhëtonin në Mekë për të kryer peligrinazhin vjetor të Haxhit.”<sup>24</sup>

Fondacionet nga Lindja e Mesme ndihmuan fuqimisht për ndërtimin e objekteve të kultit, të cilat gati nuk ekzistonin në fillim të viteve '90. Ato kanë kryer edhe veprimtari bamirësie dhe kanë ofruar ndihmë për shtresa të varfëra të popullsisë. Por këto fondacione “kanë tërhequr vëmendjen për disa zhvillime negative. Prania e tyre në Shqipëri dhe aktiviteti brenda komunitetit mysliman, me shtrirjen e tyre kapilare, përbënte kërcënim në tri mënyra kryesore: i) në praktikat fetare të panjohura më parë; ii) në idetë e rrezikshme që këto fondacione sollën në vend; iii) në fshehjen brenda tyre të elementëve ekstremistë dhe terroristë. Në veçanti, përhapja e Salafizmit dhe Wahhabizm-it paraqitej si ilustrim i natyrës fundamentaliste të këtyre organizatave, duke krijuar premisat për radikalizimin e islamit shqiptar dhe ekstremizmin e dhunshëm.”<sup>25</sup>

Paralelisht me ndërtimin e objekteve fetare, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (KMSH) do të duhet të plotësonte edhe nevojat për klerikë. Meqë në vend nuk ekzistonte asnjë institucion i arsimit të lartë teologjik, imamët e rinj u shkolluan jashtë shtetit, në Turqi, vendet Arabe dhe deri në

---

<sup>24</sup> Po aty

<sup>25</sup> Bumçi, A. (2004). Çështje të Sigurisë Kombëtare. Rasti i Shqipërisë. Kufiri, Feja Korrupsioni. Tiranë: AIIS Press: f. 60. Cituar në: Hide, Enri, *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, AIIS, Tiranë, 2015

Malajzi e Indonezi. Dy ishin problemet lidhur me krijimin e kësaj trupe predikuesish: së pari, një pjesë e madhe e tyre nuk dërgohej nga KMSH, por drejtpërdrejt nga fondacionet e huaja ose nga lidhjet dhe njohjet personale; së dyti, një pjesë e konsiderueshme ndoqën shkolla të besimit fetar Islam që ishin të ndryshme dhe më radikale krahasuar me shkollën Hanefi që mbizotëron në Ballkan dhe që është edhe feja e traditës për myslimanët sunitë shqiptarë.

“Këta studentë të arsimuar jashtë shtetit sot dominojnë disa xhami, medrese dhe institucione të tjera islamike në Shqipëri. Pa dyshim këta djem të rinj kanë një sens më të fortë të identitetit islamik krahasuar me myslimanët shqiptarë më të moshuar, që kanë më pak njohuri për studimet e Kuranit dhe për çështjet e përgjithshme islamike dhe që gjithashtu ndihen më shumë të lidhur me një traditë të butë osmane sesa me Islamin arab.”<sup>26</sup>

Si rezultat i këtyre zhvillimeve, sipas Vickers, gjatë viteve të fundit ka lindur një konflikt i ri mes mbështetësve më të moshuar të shkollës Hanefi dhe djemve të rinj që janë kthyer nga shkollimi fetar në mjedise islamike radikale dhe që janë mbështetës të shkollës islame Salafi, e cila është më radikale dhe shumë më pak tolerante.<sup>27</sup>

Fillimisht shqetësimi për zhvillimet në komunitetin e myslimanëve sunitë - i shfaqur edhe në media - ka qenë i lidhur me ligjërimin radikal në disa xhami të vendit dhe predikimin në to të shkollave fetare që ofronin një interpretim të huaj intolerant të Islamit. Por zbulimi nga ana e organeve të sigurisë në fund të viteve '90 i lidhjeve

---

<sup>26</sup>Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom, 2008

<sup>27</sup>Po aty



apo financimit të një pjese të fondacioneve të huaja islamike prej organizatave terroriste hodhi dritë mbi një anë tjetër të errët dhe të panjohur të problemit: atë të asociimit të aktivitetit fetar jo thjesht me radikalizmin, por edhe me ekstremizmin e dhunshëm islamist.

Lufta e ISIS në Siri dhe Irak nxori sërish në sipërfaqe praninë e këtij ekstremizmi në vend, duke zbuluar edhe ekzistencën e mercenarizmit fetar islamist. Sipas një raporti të Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH) të cituar në disa nga mediat kryesore, aktualisht në radhët e ISIS janë përfshirë rreth 140 shtetas të Shqipërisë, një numër i konsiderueshëm ky në raport me numrin e popullsisë.<sup>28</sup> Arrestimi në mars 2014 i nëntë personave, mes tyre edhe imamët e dy prej xhamive të Tiranës që ishin jashtë kontrollit të KMSH, u përcoll si zbulimi i një skeme rekrutimi të shqiptarëve që dërgoheshin për të luftuar në Siri, në të cilën akuzohen se janë përfshirë edhe predikues të fesë islame. Interesi dhe objektivi i drejtuesve të ISIS ndaj Shqipërisë dhe popullatës shqipfolëse duket edhe në faktin se shqipja është një nga gjuhët që kjo organizatë terroriste përdor në komunikimin e vet masiv.

Një problem tjetër shqetësues i shfaqur edhe në media është ekzistenca e një numri të konsiderueshëm të xhamive që janë jashtë kontrollit të KMSH. Në fillim të dhjetorit 2015, shërbimi informativ do të deklaronte se janë 89 xhami të mbetura jashtë këtij kontrolli, ndërkohë që vetë KMSH deklaroi se janë vetëm 9 të tilla.<sup>29</sup> Por ka edhe zëra që flasin për një nivel edhe më të lartë të mungesës së kontrollit. “Realisht nuk mund të jenë vetëm 89 xhami

---

<sup>28</sup> Gazeta *Shqip*, datë 14 nëntor 2015, faqe 5

<sup>29</sup> Gazeta *Panorama*, datë 26 nëntor 2015, faqe 2

jashtë komunitetit. Realisht komuniteti nuk po kontrollon, nuk po bën detyrat e veta, nuk po funksionon. Dhe unë jam i bindur që nuk janë 89 por janë 200, dhe pas një viti do të dalë gjysma e numrit total, pas tre vitesh të gjitha xhamitë do të jenë jashtë kontrollit të KMSH. Çfarë do të ndodhë më pas në këtë vend?”<sup>30</sup> – thotë në intervistën për këtë studim teologu Ermir Gjinishi, ish-nënkryetar i KMSH.

Disa studime që janë ndërmarrë në Shqipëri kohët e fundit për radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, si për shembull studimi “Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri” (IDM, 2015) apo studimi tjetër “Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri” (AIIS, 2015) e vlerësojnë situatën si “një dukuri në fazë të hershme”, “embrionale”<sup>31</sup> ose si një “zhvillim në fazë fillestare”<sup>32</sup>. Por njëherësh këto studime i shohin zhvillimet si një kërcënim për sigurinë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, që përmban edhe rrezikun e cenimit të harmonisë fetare, çka do të ishte fatale për sigurinë, stabilitetin, madje edhe për të ardhmen e vendit.<sup>33</sup>

Por pavarësisht nga hershmëria e dukurisë apo përhapja e kufizuar apo e izoluar, ajo që është shumë serioze lidhet me faktin se nëse deri në vitin 2000 ekstremizmi i dhunshëm islamist në Shqipëri identifikohet kryesisht tek individë apo organizata të huaja, sot ai identifikohet edhe tek individë apo struktura religjioze vendase. Pra dukuria

---

<sup>30</sup> Intervistë me teologun Ermir Gjinishi në kuadër të këtij studimi. Intervistoi Laert Miraku

<sup>31</sup> Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri, IDM, 2015, f. 34

<sup>32</sup> Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri”, AIIS, 2015, f.4

<sup>33</sup> Po aty

nuk është më vetëm një dukuri e importuar nga të huajt në Shqipëri, por edhe një dukuri dhe produkt vendor. Dhe paraqitet në format e veta më ekstreme. Në rastin e arrestimit të imamëve, mediat, bazuar në deklaratimet e policisë dhe të prokurorisë, flasin për prani dhe zbulim të “celulave terroriste” dhe për lidhje me krimin e organizuar.<sup>34</sup> Duke bërë një vlerësim të përgjithshëm për shkallën e zhvillimit të ekstremizmit të dhunshëm në vend, i intervistuari ynë Ermir Gjinishi përfundon: “Ne aktualisht kemi kaluar në gradën e fundit, në terrorizëm. Ne jemi një vend që prodhojmë terrorizëm dhe këtë duhet ta themi hapur: kemi prodhuar terrorizëm.”<sup>35</sup>

Ndërkohë situata në hapësirën online në gjuhën shqipe, ku vihet re një numër i madh websajtesh që promovojnë gjithfarë shkollash të huaja të interpretimit të Islamit, që nga ato më të moderuarat deri tek ato të ekstremit të skajshëm, të krijojnë përshtypjen se përveç mercenarizmit të armës, po zhvillohet edhe mercenarizmi i fjalës. Shuma të konsiderueshme shpenzohen për mbajtjen e qindra websajteve dhe gjithashtu me qindra vetë paguhen për të shkruar dhe sidomos për të përkthyer në shqip e për të përhapur ndër shqiptarët shkolla dhe doktrina fetare që janë larg traditës Hanefi. Si pasojë, nëse bombardimi i nxehtë mendohet si një rrezik potencial i largët për Shqipërinë, bombardimi i fjalës tashmë është duke ndodhur dhe vijon të intensifikohet dita-ditës.

---

<sup>34</sup> *Lufta në Siri, zbulohet celula terroriste në Tiranë*, 14.03.2014, Link: <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=42332>

<sup>35</sup> Intervistë me teologun Ermir Gjinishi në kuadër të këtij studimi. Intervistoi Laert Miraku

Reagimi i shumicës së aktorëve kryesorë në vend ndaj ekstremizmit islamist ka qenë i fortë dhe i shumëllojshëm. Në disa raste ekstreme, në komentet online, por edhe në ndonjë shkrim në gazetatat e përditshme, reagimi ka nxjerrë në pah edhe ekzistencën tek individë të ndryshëm të dy formave të tjera të ekstremizmit: ekstremizmit anti-Islam dhe ekstremizmit ateist. Duhet të bëjmë të qartë se, si ekstremizmi anti-Islam edhe ekstremizmi ateist në asnjë rast nuk shfaqen si pjesë e politikës editoriale të mediave kryesore. Njëkohësisht nuk kanë asnjë shenjë të lëvizjeve të organizuara dhe nuk kanë lidhje me aktivitetin apo ligjërimin e institucioneve fetare. Ekstremizmi anti-Islam paraqitet kryesisht si një ndikim i ideologjive politike të ekstremit të djathtë, të cilat kanë një terren absolutisht minimal dhe gati inekzistent në vend. Kurse ekstremizmi ateist paraqitet si një ndikim i ideologjive politike të ekstremizmit të majtë, kryesisht si reminishencë e mbetjeve ideore apo e trashëgimisë nga e kaluara e afërt komuniste e vendit.

## **4. Metodologji dhe instrumente të matjes së ekstremizmit fetar në media**

Siç e kemi thënë edhe më sipër, ky studim fokusohet kryesisht në hulumtimin dhe analizën e diskursit ekstremist fetar në media. Diskursi normativ apo ai që konsiderohet “politikisht korrekt” nuk është pjesë e këtij studimi. Objekt i kërkimit janë shtypi në Shqipëri dhe media online në gjuhën shqipe. Metodot kryesore kërkimore-studimore janë monitorimi dhe analiza e përmbajtjes. Por për nevoja të studimit janë kryer edhe një grup intervistash me përfaqësues të komuniteteve fetare në vend apo me ekspertë të fushës.

Nga shtypi janë përzgjedhur gazetat “Panorama”, “Shqip” dhe “Tema”, të cilat janë monitoruar për një periudhë katërmujore: nga 1 gushti deri në 30 nëntor 2015. Kriteret e zbatuara në përzgjedhjen e këtyre gazetave kanë qenë: 1. Prania në kampionin që studiohet e gazetës më të shitur në vend (Panorama), 2. Prania në kampionin që studiohet e një gazete që i lë një vend të konsiderueshëm përmbajtjes specifike (Shqip) dhe 3. Prania në kampionin që studiohet e një gazete me profil popullor (Tema).

Në median online kërkimi ka qenë i strukturuar në dy akse: 1. Kërkim sipas problematikës që lidhet me ekstremizmin, pra kërkim i bazuar tek tematika përkatëse dhe fjalëkyçet e saj; 2. Kërkimi i bazuar te ngjarjet kryesore që lidhen me objektin e studimit.

Në kërkimin tematik, fjalëkyçet kryesore që u përdorën për kërkim kanë qenë: feja në Shqipëri, identiteti fetar, identiteti kombëtar, toleranca fetare, ekstremizmi, radikalizmi, fundamentalizmi, terrorizmi, islamizmi, islami politik, ekstremizmi islamist, islamofobia, ekstremizmi anti-Islam, ekstremizmi ateist, etj.

Kurse kërkimi sipas ngjarjeve është përqendruar në ndodhi kryesore, si: arrestimi i dy imamëve dhe i pesë individëve të tjerëve në Tiranë, vizita e Papës në Shqipëri, aktet terroriste në redaksinë e revistës “Charlie Hebdo”, prishja e kishës në Dhërmi, aktet terroriste të 13 nëntorit në Paris, lufta e ISIS dhe pjesëmarrja e shqiptarëve në të, si dhe disa ngjarje të tjera më pak të bujshme të zhvilluara gjatë viteve 2014-2015.

Monitorimi i mediave online ka përfshirë si websajtet mediatike edhe websajtet fetare institucionale apo individuale si dhe mediat sociale. Kërkimi online nuk ka qenë i lokalizuar territorialisht por i lokalizuar sipas gjuhës, pra në hapësirën online në gjuhën shqipe, edhe për faktin se mjaft websajte nuk deklarojnë vendin e themelimit apo të zhvillimit të veprimtarisë dhe shpesh nuk mund të ndahen websajtet e krijuara në Shqipëri nga ato të krijuara në Kosovë apo në vende të tjera.

Një monitorim i afërt/i shpeshtë i mediave dhe websajteve të tjera online është kryer për rastin e akteve terroriste në Paris, më 13 nëntor 2015. Ky monitorim ka zgjatur dy javë.

Pyetjet kryesore kërkimore-studimore ishin:

- Sa i pranishëm është në mediat shqiptare të shtypur apo online diskursi ekstremist fetar dhe në ç'forma shfaqet ai?
- A ka qenë media aktor, faktor apo mjet i propagandimit, nxitjes apo mobilizimit në shërbim të doktrinave ekstremiste fetare?

Një nga vështirësitë e këtij studimi ka të bëjë me relativitetin e konceptit “ekstremizëm” dhe me riskun për një interpretim subjektiv të tij. Për të minimizuar relativizmin dhe subjektivizmin, është gjykuar që të zbatohet një qasje më sistematike, e bazuar në kritere dhe tregues më të qartë, si dhe në disa instrumente që mundësojnë identifikim të indikatorëve dhe indeksim të tyre.

Si një bazë e mirë nisjeje në këtë kontekst ka shërbyer instrumenti “Njëzet indikatorë për monitorimin e ekstremizmit” (Extremism Monitoring Instrument: EMI-20) i përpunuar nga një grup autorësh, që paraqitet i plotë nga studiuesi Alex Schmid. Ky instrument ofron tregues të detajuar për të identifikuar ekstremizmin dhe ekstremistët, dhe ne po e paraqesim atë të plotë. Sipas EMI-20, vështruar nga një perspektivë liberal-demokratike të konsideruar si “centriste” apo “mainstream”, ekstremistët shfaqin këto prirje:

1. Vendosin veten e tyre jashtë *mainstream* dhe refuzojnë rendin ekzistues social, politik apo botëror;
2. Kërkojnë të përmbysin, me ndihmën e pararojës revolucionare sistemin politik në mënyrë që të (ri)ndërtojnë atë që ata e konsiderojnë si rend natyral të shoqërisë – qoftë ky një rend i bazuar në superioritetin racor, klasor, fetar, etnik apo në një traditë të pretenduar;

3. Zakonisht zotërojnë një program ideologjik apo një plan veprimi për marrjen dhe mbajtjen e pushtetit lokal apo qendror;
4. Refuzojnë, ose kur janë në pushtet shkatërrojnë, konceptin liberal-demokratik të sundimit të ligjit; përdorin hapësirën politike që zotërojnë për të lartësuar kauzën e tyre në përpjekje për të marrë pushtetin;
5. Refuzojnë të drejtat universale të njeriut dhe shfaqin një mungesë empatie dhe mospërfillje për të drejtat e njerëzve jashtë grupit të tyre;
6. Refuzojnë parimet demokratike të bazuara në sovranitetin e popullit;
7. Refuzojnë të drejta të barabarta për të gjithë, veçanërisht për gratë dhe minoritetet;
8. Refuzojnë diversitetin dhe pluralizmin duke favorizuar shoqërinë e tyre monokulturore të preferuar, si për shembull një shtet islamik mbarëbotëror;
9. Ndjekin filozofinë “qëllimi (i mirë) përlligj (të gjitha) mjetet” për të arritur pikësynimet e tyre;
10. Mbështesin dhe glorifikojnë aktivisht përdorimin e dhunës për të luftuar atë që ata e konsiderojnë “djall” dhe për të arritur objektivat e tyre politike (për shembull, në formën e xihadit);
11. Shfaqin një prirje për t’u përfshirë në dhunën masive ndaj armiqve aktualë dhe potencialë kur janë në pushtet apo kur përfitojnë nga pandëshkueshmëria;
12. Janë të devotshëm, mendojnë bardh-e-zi dhe kërkojnë të purifikojnë botën si dhe të demonizojnë, përuhin e dehumanizojnë armiqtë e tyre përmes gjuhës së urrejtjes, duke i karakterizuar ata si “inferiorë” dhe duke i damkosur, qartazi apo tërthorazi, si të pavlerë;



13. Ia nënshtrojnë liritë individuale qëllimeve kolektive;
14. Refuzojnë të përfshihen në kompromise të singerta (përkundër atyre taktike apo të përkohshme) me palën tjetër dhe kërkojnë në mënyrë ultimative mposhtjen apo eliminimin e armikut;
15. Shfaqin intolerancë ndaj të gjitha pikëpamjeve të ndryshme nga pikëpamja e tyre dogmatike dhe e shprehin këtë përmes zemërimit, sjelljes agresive dhe gjuhës së urrejtjes;
16. Shfaqin fanatizëm, e portretizojnë veten e tyre si të kërcënuar dhe përqafojnë teori konspirative duke mos qenë domosdoshmërisht irracionale në zgjedhjet e tyre strategjike;
17. Shfaqin tipare autoritariste, diktatoriale apo totalitariste;
18. Nuk janë të gatshëm të pranojnë kritikën dhe frikësojnë e kërcënojnë me vdekje kundërshtarët, heretikët dhe kritikët;
19. Kërkojnë bindje ndaj kërkesave dhe urdhrave të tyre, pa lejuar diskutimin e pikëpamjeve dhe të politikave as brenda grupit të tyre;
20. Kanë ide fikse, janë mendjembyllur dhe besojnë se ka vetëm një të vërtetë – ajo e tyre. Në ndjekjen e saj ata janë shpesh të gatshëm të përballen me ndëshkim, madje edhe me vdekje dhe në disa raste kërkojnë aktivisht të martirizohen.<sup>36</sup>

Ky sistem indikatorësh mbulon një spektër të gjerë të termit dhe të ideologjive ekstremiste. Por në mënyrë të veçantë ai na ndihmon për të bërë dallimin mes

---

<sup>36</sup>Schmid, Alex P., *Violent and Non-Violent Extremism: Two Sides of the Same Coin?*, ICCT Research Paper, May 2014

ekstremizmit islamist dhe formave të tjera të sjelljes apo ligjëritimit politik, duke nisur që nga protestat në formën e mospërputhjes së mendimeve, dhe deri te format e aktivizmit dhe të radikalizmit që janë kritike dhe antikonformiste ndaj një rendi ekzistues socio-politik, por që në ndryshim nga ekstremizmi islamist, nuk përbëjnë rrezik fundamental për liberal-demokracinë. Me pak fjalë ky instrument mundëson identifikimin e prirjeve ekstremiste tek individët dhe grupet që sfidojnë shoqëritë e hapura demokratike.<sup>37</sup>

Përpos instrumenteve identifikuese të ekstremizmit në përgjithësi, për këtë studim ka qenë e rëndësishme edhe gjetja dhe zbatimi i mekanizmave metodologjikë që identifikojnë posaçërisht ekstremizmin në diskursin e medias. Një mekanizëm i tillë është “Indeksi i mediave ekstremiste” i propozuar nga Donald Holbrook. Ne e kemi zbatuar atë në kuadër të këtij studimi për indeksimin e përmbajtjeve ekstremiste në mediat shqiptare. Bazuar në këtë Indeks përmbajtja ekstremiste ndahet në tre kategori:

1. Përmbajtje e moderuar
2. Përmbajtje në zgrip (anglisht: *fringe*)
3. Përmbajtje ekstreme.

Kjo e fundit ndahet më tej në disa nënkategori: përmbajtje ekstreme e nivelit 1, përmbajtje ekstreme e nivelit 2, përmbajtje ekstreme e nivelit 3 dhe përmbajtje ekstreme e nivelit 3b.<sup>38</sup>

---

<sup>37</sup> Po aty

<sup>38</sup> Holbrook, Donald, *Designing and Applying an “Extremist Media Index”*, Perspectives on Terrorism Volume 9, Issue 5, 2015

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar indeksin e Holbrook me kategoritë përkatëse dhe përshkrimin për çdo kategori apo nënkategori.


*Tabelë e indeksit të ekstremizmit në media*

Kategorizimi i shkallës së parë	Përshkrimi
1 – E moderuar	Materiale dhe komente të përgjithshme fetare, politike, filozofike dhe historike që nuk ofrojnë qasje miratuese ndaj dhunës apo urrejtje ndaj komuniteteve të identifikuara, me një përmbajtje përgjithësisht të moderuar deri në fund dhe që gjendet në tekstet fetare/ politike si dhe në produktet e mediave të lajmit.
2 - Në zgrip (anglisht: <i>fringe</i> )	Nga pikëpamja fetare apo ideologjike përmbajtja është konservatore dhe izolacioniste, politikisht radikale dhe konfrontuese, por që përlligj dhunën në skenaret aktuale. Mund të ketë shprehje të zemërimit apo të armiqësisë ndaj një grupi të caktuar njerëzish, për shembull “të pafetë” apo emigrantët, por pa arritur deri në përfundimin se ata janë qenie nën-humane dhe objektiv i logjikshëm i dhunës.
3 - Ekstreme	Materiale që legjitimojnë dhe/ose glorifikojnë përdorimin e dhunës (sidomos të dhunës serioze dhe potencialisht fatale, për të arritur qëllime të caktuara) si dhe luftëtarët dhe martirët që vdesin për një kauzë, me një lloj aluzioni që i sheh këto eksperiencia si eventualisht relevante për aktivistët aktualë. Gjithashtu në këtë kategori përfshihen edhe materialet që fokusohen në dehumanizimin e

	komuniteteve të veçanta duke ngritur çështje të racës, seksualitetit, të origjinës apo aspekte të tjera që i paraqesin këta njerëz si “nën-humanë”, duke iu hequr kështu të drejtën për të jetuar. Kështu kjo kategori përfshin si publikimet që avokojnë dhunën e “xhihadit” kundër luftëtarëve apo civilëve edhe disa punë të ekstremit të djathtë, për shembull, të cilat mund të jenë më të patejdukshme në terma të referencës ndaj dhunës, por që kanë një fokus që i paraqet njerëz të tillë si hebretë apo njerëzit jo të bardhë si nën-humanë në kontekstin e një ballafaqimi të imagjinuar apo të parashikuar me këtë grup njerëzish.
<b>Kategorizimi i shkallës së dytë</b>	<b>Përshkrimi</b>
Ekstreme e nivelit 1	Përligjet/promovohet/mirëpritet vetëm dhuna serioze (potencialisht fatale) ndaj trupave militare, duke u bërë kjo në mënyrë ta paqartë dhe të padetajuar, për shembull duke folur për dobritë e dhunës kolektive apo duke glorifikuar betejat kryengritëse
Ekstreme e nivelit 2	Përligjet/promovohet/mirëpritet qartazi dhuna serioze (potencialisht fatale) ndaj civilëve, por pa dhënë detaje, për shembull, “vrisni myslimanët” apo “zhdukini ta pafetë”
Ekstreme e nivelit 3	Përligjet/promovohet/mirëpritet qartazi dhuna serioze (potencialisht fatale) ndaj civilëve, duke ofruar edhe detaje lidhur me lehtësimin, shtrirjen apo drejtimin, për shembull, “kryeni akte vetëvrasëse” (ndaj civilëve), “vini në objektiv ekonominë”.
Ekstreme e nivelit 3b	E njëjtë me 3, por më specifike, duke ofruar detaje të drejtpërdrejta të zbatimit, për shembull, udhëzimet për krijimin e bombave

Më poshtë po paraqesim një paraqitje grafike dhe të përmbledhur të indeksit.

### Indeksi i ekstremizmit në media



Për të bërë indeksimin e materialeve sipas këtij kallëpi modelor është dashur një njohje e thelluar e përmbajtjes së tyre dhe klasifikim i saj për të përcaktuar vendin e çdo materiali në këtë indeks. I kombinuar me Instrumentin e Monitorimit të Ekstremizmit EMI-20, indeksi i Holbrook krijon mundësinë për një qasje sasiore ndaj përmbajtjes së monitoruar dhe njëherësh lehtëson identifikimin e elementeve nga pikëpamja cilësore, duke ndihmuar që të hulumtohen termat më të debatuar të diskursit, pikërisht ato që përcjellin semantikën ekstremiste dhe që përfaqësojnë çështjet më të debatuar në opinionin publik shqiptar në kontekstin që studiohet.

## 5. Diskursi ekstremist fetar në mediat shqiptare – qasje sasiore

Analiza sasiore e kryer në kuadër të këtij studimi përdor si “njësi matëse” mekanizmin që ofron Indeksi i Holbrook. Identifikimi i materialeve gjatë monitorimit si dhe klasifikimi dhe përcaktimi i vendit të tyre në Indeks të Holbrook nuk ka qenë një punë e lehtë. Siç thotë edhe vetë autori i Indeksit, është pashmangshmërisht e vështirë që të gjejmë parametra objektive për një gjë kaq të debatueshme siç është diskursi fetar apo ideologjik. Kështu procesi nuk e shmang dot subjektivitetin. Mes kategorive të ndryshme ka zona gri ku kufiri është i vështirë për t’u përcaktuar, sidomos në zonën ku ndahen materialet në zgrip nga ato ekstreme të nivelit të parë, ku mund të ndodhë që kategoritë të mbivendosen.<sup>39</sup> Gjithsesi kriteret e ofruara nga Indeksi pretendojnë të minimizojë shkallën e subjektivitetit.

Nga monitorimi i tre gazetave të përmendura më sipër, si dhe i hapësirës online në gjuhën shqipe janë

---

<sup>39</sup> Holbrook, Donald, *Designing and Applying an “Extremist Media Index”*, Perspectives on Terrorism Volume 9, Issue 5, 2015

identifikuar 284 materiale që i përkasin të gjithë spektrit të indeksit, duke nisur nga materialet e moderuara deri te materialet ekstreme. Një numër prej 201 materialesh janë identifikuar në median online, kurse 83 janë identifikuar në shtyp.

Një diskurs ekstremist është zhvilluar edhe në komentet online, poshtë shkrimeve të botuara në websajte të ndryshme, por duke qenë se këto komente janë anonime, tejet vulgare dhe larg të qenit një fakt i kërkimit shkencor, ato nuk janë përfshirë në objektin e këtij punimi.

Pas indeksimit të lëndës së identifikuar, bie në sy menjëherë fakti që në mesin e materialeve të identifikuara, mbizotërojnë materialet që kanë përmbajtje të kategorisë “E moderuar” të cilat plotësojnë kriteret e Holbrook për këtë kategori pasi janë “materiale dhe komente të përgjithshme fetare, politike, filozofike dhe historike që nuk ofrojnë qasje miratuese ndaj dhunës apo urrejtje ndaj komuniteteve të identifikuara, me një përmbajtje përgjithësisht të moderuar deri në fund dhe që gjendet në tekstet fetare/politike si dhe në produktet e mediave të lajmit”.

Në grupin e materialeve “Në zgrip” janë identifikuar dhe përfshirë ato materiale në të cilat, sipas kriterit të Holbrook, përmbajtja, nga pikëpamja fetare apo ideologjike është konservatore dhe izolacioniste, politikisht radikale dhe konfrontuese, por që nuk përcjell përligjje të dhunës në skenaret aktuale. Në materiale të tilla mund të ketë edhe shprehje të zemërimit apo të armiqësisë ndaj një grupi të caktuar njerëzish, por pa arritur deri në përfundimin se ata janë qenie nën-humane dhe objektiv i logjikshëm i dhunës.

Gjatë analizës sasiore të këtij studimi, në mediat e monitoruara janë ndeshur edhe materiale të kategorisë



“Ekstreme”, por këto materiale nuk janë të shumta dhe ato shfaqen kryesisht në mediat online. Në shtyp ndeshen më së shumti raportime apo denoncime për këtë lloj diskursi dhe, megjithëse në disa prej këtyre raportimeve sillen edhe tekstet e plota ekstreme të verifikuara në mediat online, kjo nuk konsiderohet nga ky studim si pjesë e axhendës së vetë shtypit.

Sqarojmë me këtë rast se materialet e kategorisë “Ekstreme” në mjedisin online qarkullojnë kryesisht në format e komunikimit konfidencial ndërpersonal të zhvilluar përmes rrjeteve sociale apo chat-it, në të cilat praktikisht është e pamundur të hyjë mekanizmi i monitorimit. Për këtë arsye, kërkimi ynë është përqendruar kryesisht tek ato materiale dhe platforma që kanë qenë të mundshme për t’u aksesuar dhe monitoruar.


Në mesin e materialeve online të kategorisë “Ekstreme” janë verifikuar materiale që përmbajnë miratim dhe glorifikim të dhunës në kontekste bashkëkohore dhe dehumanizim të tjetrit, për shembull, deklarata e një ekstremisti që për ligj ekzekutimin e tmerrshëm të pilotit të forcave ajrore jordaneze nga forcat e ISIS, shfaqja e simpatisë për terroristë të njohur shqiptarë në radhët e ISIS, thirrja për nderjen e xhihadit në Rusi dhe vrasjen e ushtarëve rusë, videoja kërcënuese në gjuhën shqipe që kërcënon shqiptarët me vënie eksplozivësh, videoja tjetër që u bën thirrje shqiptarëve të Maqedonisë për të rrëmbyer armët për luftë të shenjtë, thirrja e një imami për të kaluar në Intifadën e tretë kundër hebrejve dhe për vrasje me thikë të tyre, shkrimi që promovon vrasjen si ndëshkim për homoseksualët, etj.

Nga indeksimi total i të gjitha materialeve të identifikuara bie në sy se në rastin e shtypit, diskursi

shkon deri te shkalla “Në zgrip” dhe nuk vërehen raste të diskursit “Ekstrem”. Ndërsa në mediat online, diskursi ekstremist arrin deri në nivelin “Ekstrem 3”.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë grafike shtrirjen e spektrit për dy grupimet e mediave të monitoruara 1. Gazetat, 2. Mediat online:

*Shtrirja e spektrit të ekstremizmit për dy grupimet e mediave të monitoruara*




Më konkretisht, ndarja e materialeve sipas kategorive paraqitet në tabelën dhe grafikën e mëposhtme:

*Tabelë e ndarjes së materialeve sipas kategorive të Indeksit*

Kategoria e medias / lloji i materialeve	E moderuar	Në zgrip	Ekstreme
Shtypi	58	25	0
Media online	136	57	8

Grafikë e ndarjes së materialeve sipas kategorive të Indeksit



Siç shihet edhe nga tabela dhe grafiku i mësipërm, numri më i madh i materialeve në total është gjetur në mediat online. Kjo ka ndodhur për disa arsye: së pari, sepse mediat online kanë më pak *gatekeepers*; së dyti, shumë media online, sidomos ato të karakterit fetar janë themeluar nga organizata të huaja me qendër në vende ku ekstremizmi fetar është tradicionalisht më i lartë, dhe për rrjedhojë edhe diskursi ekstremist në to është më i pranishëm; së treti, numri i mediave online të monitoruara është shumë më i madh se ato të shtypura; së katërti, periudha e monitoruar për mediat online është më e gjatë.

Ndërkohë raporti proporcional mes materialeve të kategorisë “E moderuar” dhe atyre “Në zgrip”, në rastin e shtypit dhe të mediave online është i përafërt.

Duhet thënë se një pjesë e materialeve në tërësi janë identifikuar në websajtet fetare, kryesisht në ato të fesë Islame, të cilat në gjuhën shqipe rezultojnë të jenë në një numër shumë të madh në raport me numrin e popullsisë dhe përmbajnë literaturë dhe qasje konservatore nga pothuaj të gjitha shkollat dhe rrymat fetare të Islamit

që zhvillohen aktualisht në botë. Në intervistën me nënkryetarin e Komunitetit mysliman të Shqipërisë, ai thotë se Komuniteti ka vetëm tre websajte të vetat: websajtin institucional (<http://www.kmsh.al/>) si dhe dy websajtet e revistave të komunitetit Drita Islame dhe Zani i Naltë. Ndërkohë monitorimi i kryer në kuadër të këtij studimi, ka vërejtur ekzistencën e disa qindra websajteve fetare Islame në gjuhën shqipe. Kjo tregon se, nëse në rastin e territorit fizik, vetëm një pakicë e tij është jashtë kontrollit të KMSH, në rastin e “territorit” virtual të fesë Islame shqiptare shumica absolute e saj është jashtë kontrollit apo vëmendjes së KMSH.<sup>40</sup>

---

<sup>40</sup> Intervistë me Bujar Spahiun, Nënkyetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, e zhvilluar në kuadër të këtij studimi. Intervistoi Laert Miraku

## **6. Diskursi ekstremist fetar në mediat shqiptare – qasje cilësore**

Aktualisht forma më e përhapur dhe më aktive e diskursit fetar ekstremist në gazetatat dhe në mediat online, siç rezulton edhe nga monitorimi i kryer, është diskursi ekstremist islamist. Ky diskurs zhvillohet njëherësh në dy kontekste: në kontekstin global dhe në atë lokal. Në kontekstin global ky diskurs synon të promovojë dhe të nxisë përhapjen e Islamit politik, duke e paraqitur atë si modelin e vetëm dhe të drejtë të organizimit të shoqërisë njerëzore, i cili i tejkalon kufijtë dhe kombet dhe paraqitet si një model universal që do të sfidojë dhe zëvendësojë edhe modelin “në krizë” të shoqërive moderne liberal-demokratike. Në kontekstin lokal shqiptar ky diskurs synon të sfidojë ato tipare dhe ato vlera specifike të shoqërisë shqiptare, të cilat shihen si barriera për modelin shoqëror të Islamit politik.

Më poshtë po paraqesim format dhe termat kryesore të këtij diskursi të shfaqura në shtyp në Shqipëri dhe në mediat online në gjuhën shqipe.

## ***Identiteti fetar përkundër identitetit kombëtar***

Në një shoqëri multifetare si shoqëria shqiptare, është e pamundur që feja, cilado qoftë ajo, të shërbejë si njësi unifikuese dhe integruese për të gjithë shoqërinë. Duke qenë të ndërgjegjshëm për këtë, elitat e vendit, qysh në kohën e Rilindjes, kanë ofruar dhe promovuar si njësi unifikuese dhe integruese identitetin kombëtar. Në emër të paqes dhe të harmonisë sociale, ky identitet është vlerësuar dhe pranuar gjerësisht si parësor në raport me identitetin fetar dhe identitetet e tjera.

Kësisoj, për dilemën identitet fetar/identitet kombëtar në Shqipërinë moderne ka ekzistuar historikisht një përgjigje e qartë, e formuluar në thënien e njohur të Pashko Vasës “feja e shqiptarit është shqiptaria”. Duke patur një mbështetje masive popullore përparësia e identitetit kombëtar mbi atë fetar, mund të konsiderohet jo vetëm si një nga vlerat e çmuara por edhe si një tipar modelor i ndërtimit dhe funksionimit të shoqërisë shqiptare. Për këtë arsye, në këndvështrimin e këtij studimi, çdo lloj pikëpamjeje që sfidon apo kërkon përmbysjen e raportit identitet kombëtar/identitet fetar në favor të këtij të fundit, çmohet si një prirje apo shfaqje e ekstremizmit.

Identiteti kombëtar shqiptar është gjendur përpara sfidave të ndryshme gjatë historisë, por sfida më e hapur dhe më e rrezikshme ndaj tij është shfaqur vetëm gjatë viteve të fundit dhe ajo vjen nga diskursi ekstremist islamist, i paraqitur apo i raportuar edhe në media. Shprehje tipike e këtij diskursi është deklarata “Më së pari jam mysliman, pastaj shqiptar”, e bërë nga një i intervistuar në emisionin “Opinion” të TV Klan dhe i raportuar

gjerësisht nga pothuaj të gjitha mediat shqiptare<sup>41</sup>. Një personazh tjetër, edhe ky i intervistuar nga mediat gjen rastin që të shprehë edhe krenarinë vetjake për faktin që përpara kombit ka si zgjedhje të parë fenë: “Unë kam fenë përpara dhe këtë e them me krenari që nuk e fsheh aspak. Ai që e fsheh këtë nuk ka lidhje me islamin.”<sup>42</sup> Përpos deklarimeve individuale, në media raportohet edhe për forma të organizuara siç është lëvizja “Jam krenar që jam mysliman”<sup>43</sup>, e artikuluar në kundërvënie me slogane të njohura me sfond nacionalist, siç janë sloganet “Jam krenar që jam shqiptar”, “O sa mirë me qenë shqiptar”, etj. Duket qartë se këto zhvillime, krahasuar me postulatit e Pashko Vasës dhe me realitetin shekullor të mbizotërimit të identitetit kombëtar, shënojnë një kalim të dukshëm në ekstrem.

Në një analizë të botuar në media, Veton Surroi e konsideron këtë sfidë ndaj identitetit kombëtar si rrezikun më të madh ndaj të cilit janë të ekspozuar sot shqiptarët: “Rreziku i vehabizmit dhe salafizmit mund të matet me dhunën e ISIS-it dhe këtu pa dyshim që ka shumë qytete e kombe më të rrezikuara se shqiptarët. Por, jashtë terrorizmit, shqiptarët janë kombi më i rrezikuara në Evropë ngase ISIS, gjegjësisht vehabizmi dhe salafizmi e prekin në thelbin e tij. Duke qenë kombi i cili është ndërtuar duke integruar religjionet në vete, e jo duke u ndërtuar nën ombrellën e një religjioni, identiteti kombëtar shqiptar nuk lejon që njëri religjion të zhvillojë sundimin mbi të tjerët. Në

---

<sup>41</sup> <http://www.gazetatema.net/web/2015/11/20/me-se-pari-jam-mysliman-pastaj-shqiptar-skenderbeu-nuk-eshte-heroi-im/>

<sup>42</sup> <http://www.oranews.tv/vendi/gerti-pashaj-nje-nga-muslimanet-ne-kerkim-per-terrorizem-nga-turqia-jam-i-pafajshem/>

<sup>43</sup> <http://koha.net/?id=27&l=58096>

interpretimin vehabi dhe salafi, myslimani është pjesë e një umma-je (një Bote myslimane) që është mbi kombet. Rrjedhimisht, me këtë interpretim, identiteti fetar i myslimanit shqiptar është mbi identitetin e tij kombëtar.”<sup>44</sup>

Janë disa faktorë që e rrisin ndjeshëm shkallën e këtij rreziku.

**Së pari**, kemi të bëjmë me një diskurs të importuar nga realitete dhe kontekste të tjera që po i diktohet realitetit shqiptar përmes një fushate fundamentaliste dhe radikalizuese. “Kemi një ligjërim radikal në Shqipëri, që është i lindur dhe që i referohet ngjarjeve që ndodhin jashtë Shqipërisë. Këtu nis një keqinterpretim i madh fetar. Nuk mund të mbarten dukuri fetare nga vende të tjera, mbi bazë të të cilave të artikulohej gjykime apo qëndrime fetare, në një mjedis ku nuk ekzistojnë siç është ky i yni”<sup>45</sup> - thotë teologu Ermir Gjinishi.

Qasja që vendos fenë mbi çdo lloj identiteti në rastin shqiptar është një qasje e importuar kryesisht nga Lindja e Mesme, ku një mori vendesh monofetare islamike organizohen dhe madje edhe qeverisen mbi bazë të dogmës fetare. Por për një vend multifetar si Shqipëria kjo qasje cenon ekuilibrat jetikë të shoqërisë, mes të cilave dallohen pluralizmi dhe harmonia fetare si dhe sekularizmi i dëshiruar dhe i pranuar nga të gjithë.

**Së dyti**, shkalla e rrezikut rritet edhe nga fakti se diskursi nënvlerësues ndaj kombit dhe identitetit

---

<sup>44</sup> Surroi, Veton; *Terrorizmi/ Pse ne jemi më të rrezikuarit?*

Link:<http://www.lapsi.al/ide/2015/11/27/terrorizmi-pse-ne-jemi-m%C3%AB-t%C3%AB-rrezikuarit>

<sup>45</sup> Intervistë me teologun Ermir Gjinishi në kuadër të këtij studimi. Intervistoi Laert Miraku



kombëtar po paraqitet si një qasje e fesë Islame dhe po zhvillohet e po përhapet nga predikues e teologë vendorë të kësaj feje si dhe nga media offline apo online në gjuhën shqipe. Në një nga intervistat e përmendura më sipër, i intervistuari thotë më tej: “Islami si fe nuk e pranon konceptin e shtetit komb sepse në Islam është e urryer dashuria kombëtare dhe urrejtja kombëtare. Prandaj edhe profeti Muhamet ka thënë që nuk ka përparësi i bardhi nga i ziu, i ziu nga i bardhi dhe normalisht nuk ka përparësi arabi nga jo arabi dhe islami nuk e ka njohur shtetin komb edhe gjatë perandorisë osmane, po ta keni vërejtur, kanë ekzistuar shumë kombe brenda asaj perandorie dhe pse ishin një shtet i vetëm.”<sup>46</sup>

Në artikullin me titullin “Feja apo kombi: Si e shqyrton Feja Islame këtë çështje?”, sillen edhe argumenta të tjerë në favor të parapëlqimit për fenë: “Duhet të dihet njëherë e përgjithmonë se feja është para së gjithash, dhe në prizmin e fesë, d.m.th. asaj Islame shikohet edhe kombi... Krijimi i kombit është paraqitur shumë më vonë, ndërsa feja ka ekzistuar shumë, shumë përpara kombit.”<sup>47</sup>

Natyrisht nuk kërkohen njohuri të thella teologjike për të vërejtur se ky nuk është këndvështrim fetar, por një diskurs i pastër politik, i ndikuar dhe i frymëzuar nga diskursi i ideologjisë politike islamiste.

**Së treti**, nivelin e alarmit dhe të rrezikut e shtojnë disa sulme të viteve të fundit ndaj simboleve apo figurave të njohura të krenarisë kombëtare, si Gjergj Kastrioti –

---

<sup>46</sup> <http://www.oranews.tv/vendi/gerti-pashaj-nje-nga-muslima-net-ne-kerkim-per-terrorizem-nga-turqia-jam-i-pafajshem/>

<sup>47</sup> <http://www.albislam.com/feja-apo-kombi-si-e-shqyrton-feja-is-lame-kete-ceshtje/>

Skënderbeu, Nënë Tereza, etj. Edhe më shqetësuese bëhet situata, kur vihet re që fushata denigruese ndaj këtyre simboleve zë fill dhe zhvillohet nga individë të njohur të komunitetit mysliman.

Një nga mbështetësit e Islamit politik në Kosovë, në një intervistë shprehet: “përderisa Skënderbeu derdhi gjak shqiptari për motive fetare unë nuk mund ta quaj hero kombëtar.” Më tej ai argumenton: “Sipas librave autentikë të historisë dhe sipas historianëve e analistëve nga Tirana u qartësuan shumë gjëra. Se Skënderbeu nuk kishte ngritur flamurin kuq e zi në Krujë por flamurin e Bizantit, se Kuvendi i Lezhës nuk ishte Kuvend shqiptar por ishte Kuvend i kombeve të ndryshme të besimit të krishterë për të luftuar Perandorinë Osmane. Pra, Kuvendi ishte në bazë fetare dhe jo në bazë kombëtare, sepse në mesjetën e hershme kombet nuk kishin lindur ende dhe nuk kishte kurrfarë rëndësie se çfarë gjuhe flisje kur vihej përpara interesi fetar. Sipas historisë, Skënderbeu, me t’u kthyer në Krujë, iu tha myslimanëve shqiptarë të zgjidhnin mes krishterimit ose vdekjes; shumica e tyre refuzuan të braktisnin besimin islam dhe i masakroi pa mëshirë.”<sup>48</sup>

Nuk është e rastësishme që pas Skënderbeut, vihet në shënjestër me të njëjtën sintaksë ligjërimit edhe Nënë Tereza: “Para se të lexojë Rusoin e Kullës, myslimani mëson gërmat e shqipes në abetare me Nënë Terezën, simboli më i pastër i çkombëtarizimit në emër të vokacionit fetar”.<sup>49</sup>

---

<sup>48</sup> <http://www.gazetaexpress.com/intervista/interviste-me-amir-ahmetin-ferid-agani-e-ka-degraduar-ministrine-dhe-partine-skenderbeu-kishte-masakruar-shqiptare-muslimane-2163/?archive=1>

<sup>49</sup> *Myslimanët shqiptarë përballë ekstremizmit “laik”*, Link: <http://www.e-zani.com/2015/12/14/myslmanet-shqiptare-perballe-ekstremizmit-laik/>

Gjatë gjithë historisë së tyre, shqiptarët i kanë adhuruar dhe lartësuar Skënderbeun, Nënë Terezën apo idhuj të tjerë për origjinën e tyre shqiptare dhe jo për origjinën fetare dhe kontributet e tyre i kanë parë si pjesë e krenarisë dhe e përkatësisë kombëtare dhe jo si pjesë e ndonjë lloj krenarie apo përkatësie fetare.

Diskursi ekstremist ndjek linjën e kundërt. Për t'i zhvlerësuar këto simbole kombëtarisht, ai përpiqet t'i "kompromentojë" fetarisht. Ky diskurs rreket të provojë se gjithçka jomyslimane në Shqipëri është njëherësh edhe jokombëtare. Dhe rrjedhimisht, është kombëtare vetëm ajo që është myslimane. Ka qenë ky lloj diskursi që ka frymëzuar edhe ekstremistët e dhunshëm të kryejnë akte vandale ndaj bustit të Skënderbeut<sup>50</sup> apo të tjerë që bëjnë thirrje që "urgjent të hiqet busti i saj (i Nënë Terezës – shënim i autorit) nga të gjitha sheshet e Shqipërisë sepse ajo ka një kryq në të gjitha ato buste"<sup>51</sup>.

Duke përdorur metrin fetar për të përcaktuar njësinë kombëtare, synimi i diskursit islamist është të promovohet krijimi i një shoqërie në të cilën identiteti kombëtar duhet t'i nënshtrohet identitetit fetar. Sipas këtij diskursi, jo simbolet kombëtare por "minaret e xhamisë janë shenja qenësore të dallimit mes nesh dhe armiqve sllavo-ortodoksë"<sup>52</sup>.

---

<sup>50</sup> <http://www.gazetatema.net/web/2014/02/19/fo-to-lajmgjendet-i-perdhosur-busti-i-skenderbeut-esh-te-gjysme-cjap-gjysme-njeri-madje-ka-bisht/>

<sup>51</sup> <http://www.balkanweb.com/site/pse-e-leme-gonxhen-e-per-jetshme-te-shqiptareve-ne-harrese/>, komentet për shkrimin.

<sup>52</sup> *UNESCO dhe histeria jonë kolektive ndaj vendeve muslimane*, Link:<http://observer.al/unesco-dhe-histeria-jone-kolektive-ndaj-vendeve-muslimane/>

Në përpjekjet për çkombëtarizimin e shoqërisë dhe njësimin e saj me një fe të vetme, tezat ekstremiste arrijnë deri në kufijtë e absurdit, duke propaganduar se në trojet ku sot janë vendosur shqiptarët, nuk ka patur shqiptarë deri vonë dhe se ata i ka sjellë këtu Turqia,<sup>53</sup> ose duke propaganduar se “Islami në trojet shqiptare ka mbërritur kohë para osmanëve”<sup>54</sup>.

Përballë kësaj panorame të këtij ligjërimit antikombëtar është e natyrshme që në kuadër të këtij studimi të bëhet pyetja: Cila ka qenë roli i medias në këtë mes? Nga monitorimi ynë rezulton se ky diskurs më së shumti është i denoncuar dhe jo i promovuar nga vetë media. Por sërish, prania në axhendë dhe hapja e medias ndaj personazheve ekstremistë, si në rastin e disa intervistave në gazeta e kanale televizive, mund të bëhet bazë për mbjelljen apo përforcimin e tezave ekstremiste.

### ***Toleranca fetare dhe “leximi tjetër për tjetër “ i saj***

Pas pranimit të identitetit kombëtar si një identitet parësor në raport me atë fetar, një sfidë jetike për shoqërinë shqiptare në kuadër të sendërtimit të paktit të saj social ka qenë edhe gjetja e formulës më të mirë të mundshme të bashkëjetesës fetare. Kjo formulë e zbatuar dhe e sprovuar edhe në dallgët e historisë emërtohet shpesh “tolerancë fetare” apo “harmonitë fetare”. Duhet thënë se toleranca fetare në Shqipëri ka qenë dhe është

---

<sup>53</sup> <http://www.tetovasot.com/2015/04/hoxhe-irfan-salihu-ne-kosove-ska-pasur-shqiptare-ata-i-solli-turqia-video/>

<sup>54</sup> *Muhamed Sytari: Islami në trojet shqiptare ka mbërritur kohë përpara osmanëve*, Gazeta Mapo, 15 gusht 2015

pjesë e qenësishme e rendit ekzistues social. Ajo nuk është një hipotezë sociale, por një fakt social. Duke patur parasysh se një nga shenjat e ekstremizmit është edhe sfida ndaj një rendi social apo pakti social ekzistues, në qasjen e këtij studimi, çdo përpjekje që sfidon apo cenon tolerancën fetare, klasifikohet si ekstremizëm, pasi paraqet një pozicion të distancuar nga situata *mainstream*. Serioze në rastin shqiptar janë sidomos ato qasje sfiduese ndaj tolerancës fetare të cilat frymëzohen nga intoleranca tipike e disa prej doktrinave ekstremiste, siç janë islamizmi apo ateizmi.

Në diskursin e mediave shqiptare, sfida ndaj tolerancës fetare paraqitet në forma të ndryshme. Por forma më e pranishme në mesin e shkrimeve të kësaj kategorie është ajo që ofron një “lexim tjetër për tjetër të tolerancës mes feve”<sup>55</sup>, siç e emërton analizën e vet një analist i njohur. Në këtë optikë të leximit të dukurisë, mbizotëron debati kontraversal, që merret me analizë të termave dhe faktorëve të supozuar dhe ngre pikëpyetje e dyshime shpesh të panevojshme lidhur me ekzistencën e tolerancës fetare në Shqipëri.

Në kuadrin e këtij lloji “debati për debat” ka autorë që përpiqen të provojnë se një fakt real siç është toleranca fetare, është thjesht një “mit i rremë”, “fasadë”, “thjeshtëzim i tepruar i historisë”, “artificë”, etj. Autori i shkrimit “Toleranca fetare në Shqipëri fasadë apo e vërtetë?”, nga këndvështrimi i tij, nuk sheh tolerancë në këtë proces: “Fatkeqësisht mendoj se kemi të bëjmë me një

---

<sup>55</sup> *Leximi tjetër për tjetër i tolerancës mes feve*, Gazeta Shqip, 29 Shtator 2015

bashkëjetesë fetare (e asistuar nga një indiferencë fetare) që jo domosdoshmërisht duhet të ketë edhe tolerancën brenda.”<sup>56</sup>

Në të njëjtën linjë, një autor tjetër e vendos në thonjëza harmoninë fetare dhe as ai nuk sheh shenja tolerance: “E vërteta historike është se ishin dy ideologji pushteti të shekujve XIX- XX: nacionalizmi, që u ndërtua duke venë shqiptarinë mbi besimet fetare e Zotin dhe komunizmi i Enver Hoxhës, që këtij nacionalizmi i shtoi edhe ateizmin, ato që kanë sjellë «harmoninë» fetare duke i bërë shqiptarët indiferentë ndaj feve, por jo për këtë edhe tolerantë ndaj njëri-tjetrit e të tjerëve. Përkundrazi, bash shtypja në emër të urrejtjeve nacionale e klasore i disa principeve morale universale si ato të dashurisë së njeriut për njeriun, të mëshirës e sakrificës për tjetrin, të faljes dhe pendesës, që kanë përçuar fetë në shekuj, i ka bërë edhe më të dhunshëm e intolerantë.”<sup>57</sup>

Në një qasje me sfond ateist një autor tjetër shkruan: “Shqiptarëve një gjë u duhet bërë e qartë gjithë ditën e çdo ditë. Doni ta mbani gjallë këtë komb? Ok, mos i merrni shumë seriozisht fetë. Doni t’i vini minat kombit? Bëhuni besimtarë të zellshëm.”<sup>58</sup>

Një këndvështrim i tillë e barazon besimtarin e devotshëm me ekstremistin. Por siç ka thënë edhe David

---

<sup>56</sup> <http://www.respublica.al/arkiv-opinion/toleranca-fetare-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-fasad%C3%AB-apo-e-v%C3%ABrtet%C3%AB>

<sup>57</sup> <http://perpjekja.blogspot.al/2014/09/qe-papa-francesku-temos-keqperdoret.html>

<sup>58</sup> Leximi tjetër për tjetër i tolerancës mes feve, Gazeta Shqip, 29 Shtator 2015

Cameron “Kjo është thellësisht e gabuar. Një njeri mund të jetë musliman i devotshëm dhe të mos jetë ekstremist.”<sup>59</sup>

Duhet thënë se në shumicën e shkrimeve të mësipërme, mohimi ose dyshimi për tolerancën përdoret si një mjet apo mënyrë për pohimin dhe afirmimin e saj. Në këto analiza nuk mbështetet apo promovohet intoleranca, përkundrazi i gjithë diskursi drejtohet tek arritja e një tolerance fetare sa më të vërtetë dhe sa më të plotë. Për këtë arsye shumë nga shkrimet e identifikuara më sipër mund të klasifikohen në kategorinë e përmbajtjes së moderuar.

Por megjithatë hapja në media e një debati që vë në dyshim tolerancën fetare në një kohë kur në vend dhe në mbarë botën bien kambanat e intolerancës dhe të dhunës ekstremiste, mund të konsiderohet edhe si një axhendë e gabuar në një moment të gabuar për median dhe për disa nga analistët në Shqipëri. E cila në mënyrë të tërthortë mund të favorizojë apo t’i japë argument edhe diskursit islamist të ekskluzivizmit fetar dhe të refuzimit të tolerancës e pluralizmit.

Në paktin social shqiptar toleranca fetare konsiderohet nga të gjithë si “e shenjtë” dhe jetike për të siguruar paqen sociale. Në të kundërt, intoleranca fetare mund të hedhë në erë vetë kombin dhe të ndezë në vend flakën e një lufte civile pa fund, siç ka ndodhur në ato vende ku ka mbizotëruar intoleranca fetare.

---

<sup>59</sup> <http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20130109092234/http://number10.gov.uk/news/pms-speech-at-munich-security-conference/>

## *Feja Islame në tranzicion - Salafi në vend të Hanefi?*

Rrafshimi i objekteve fetare dhe ndalimi i ritualit fetar gjatë periudhës së komunizmit, goditi rëndë edhe vetë mendimin fetar, aq sa disa teologë apo drejtues të komuniteteve fetare vënë në dyshim nëse kishte mbetur më traditë fetare apo ajo ishte shuar prej shtypjes shumëvjeçare. “Ne me aq kohë ateizëm nuk gëzonim më asnjë lloj tradite. Tradita tek ne ishte vetëm fakt historik i së shkuarës. Në realitetin shqiptar kishin humbur të gjithë elementet, faktorët dhe tiparet që krijojnë traditën”<sup>60</sup> - vë në dukje teologu Gjinishi. Kurse një nga drejtuesit e Komunitetit Mysliman thekson: “Pas viteve ‘90 u themeluan rishtas institucionet e reja fetare si objekte fizike, por më e rëndësishmja filloi të rithemelohej edhe besimi (infrastruktura shpirtërore).”<sup>61</sup>

Prej këtej mund të arrihet tek racionalja se në kushtet e mungesës së traditës, krahas ose në vend të ringjalljes mund të konsiderohet dhe të vihet në jetë edhe rithemelimi i saj. Një tezë që natyrisht ha shumë debat. Dhe që do t’i ndërlikonte së tepërmi gjërat, nëse ajo do të rezultonte të ishte pjesë e një lloj strategjie apo e vizionit për rikonstruktimin e mendimit fetar në fillim të viteve ‘90.

Strategji, apo jo, në rastin e fesë Islame në Shqipëri paralelisht me ringjalljen është zhvilluar edhe rithemelimi i saj, përmes shkollave dhe doktrinave të reja të huaja,

---

<sup>60</sup> Intervistë me teologun Ermir Gjinishi në kuadër të këtij studimi. Intervistoi Laert Miraku.

<sup>61</sup> Intervistë me Bujar Spahiun, Nënkryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, e zhvilluar në kuadër të këtij studimi. Intervistoi Laert Miraku.



të cilat tashmë janë të pranishme në shumë zona të vendit. Për pasojë, komuniteti i myslimanëve sunitë të Shqipërisë, siç vë në dukje edhe Vickers është ndarë në dy grupe rivale: Fraksioni Salafi që është një shkollë puritaniste antimoderniste që promovon një interpretim strikt të doktrinës së Islamit dhe shkolla Hanefi e traditës shqiptare që evokon një interpretim tradicional më liberal të Islamit.<sup>62</sup>

Ndaj kësaj ndarjeje nuk kanë munguar edhe shprehjet e organizuara të protestës. Në fund të dhjetorit 2015 pothuaj të gjitha mediat raportuan për një protestë të një numri besimtarësh dhe klerikësh të fesë myslimane në Librazhd ndaj frymës përçarëse që po sillnin në komunitet përfaqësuesit e rrymave të reja të interpretimit të Islamit. Në deklaratën e përfaqësuesve të klerit mysliman të lexuar në mitingun e kësaj proteste thuhej: “Jemi sot dëshmitarë të një situatë që ka sjellë përplasje me Islamin tradicional. Po goditet fryma tradicionale e fesë Islame në Shqipëri”<sup>63</sup>

Ndërkohë edhe mediat kryesore në vend e cilësojnë situatën shumë serioze: “Tash bëhet përpjekje, e një pakice të vogël, që forma tradicionale e islamit të ndryshojë, madje rrënjësisht. E kur kemi të bëjmë me një traditë qindrvjeçare, është e qartë se ajo nuk mundet të shndërrohet kaq shpejt. E vetmja formë e shndërrimit të shpejtë është dhuna, e kombinuar me trysinë e parasë, dhe për fat të keq kjo po ndodh. Sot po bëhen përpjekje që

---

<sup>62</sup> Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom, 2008

<sup>63</sup> *Imamë e hoxhallarë të Librazhdit: të ikë myftiu Taulant Bica, po përçan besimtarët*, Link: <http://www.balkanweb.com/site/ima-me-e-hoxhallare-te-librazhdit-te-ike-myftiu-taulant-bica-po-per-can-besimtare/>

interpretimi shqiptar i islamit t'u nënshtrohet interesave politike të grupeve islamike apo edhe shteteve që e sponsorizojnë atë.”<sup>64</sup>

Duhet thënë se reagimi i KMSH ndaj kësaj situate ka qenë i vakët. Lidhur me ndarjen brenda komunitetit të myslimanëve sunitë, kreu i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në një intervistë të vetën në media shprehet: “Ndonjëherë ne keqinterpretojmë edhe terminologjinë islame. Nuk do të thotë që kjo ndarje që u bëjmë ne rrymave të ndryshme, jo halafi, jo selefi, të përcaktojë gjithë komunitetin. Pra, jo të gjithë selafijtë janë problematikë.” Që nënkupton megjithatë se në radhët e selafijve ka edhe problematikë.

Në një studim të Parlamentit European vihet në dukje se salafizmi, nga i cili buron edhe fundamentalizmi islamist “është një lëvizje socio-politike që lindi në Egjipt në shekullin e 19-të në radhët e Islamit Sunit, e cila iu kundërvu integritimit me shoqëritë kryesore europiano-perëndimore. Salafistët besojnë se myslimanët duhet të kthehen në rrugën e Profetit dhe t'i përmbahen fjalë për fjalë Kuranit. Duke patur parasysh mënyrën e tyre fetare konservatore të jetesës, të gjithë salafistët mund të konsiderohen fundamentalistë, por jo të gjithë janë militantë të dhunshëm. Vetëm xhihadizmi salafist fokusohet në përdorimin e dhunës për të sjellë ndryshimin shoqëror. Xhihadistët evokojnë përdorimin e dhunës për të krijuar një Kalifat të ri dhe për të fituar territoret që dikur kanë qenë sunduar nga myslimanët. Në ndjekje të mësimave të

---

<sup>64</sup> *Shoqëritë tona të sulmuara nga islami politik*, [Gazeta Shqip](#), 30 Gusht 2015

tyre, xhihadistët refuzojnë pluralizmin fetar dhe aspirojnë sundimin e Islamit politik në të gjithë botën.”<sup>65</sup>

Pavarësisht nga ky profil i salafizmit, kjo rrymë teologjike ia doli të depërtojë në shoqërinë shqiptare dhe sot ne gjendemi përballë një fakti të kryer. Salafizmi sot ka objektet e veta të kultit (brenda apo jashtë kontrollit të KMSH), ka predikuesit e vet dhe mbështetet edhe nga një literaturë e gjerë offline dhe online në gjuhën shqipe. Sidomos në mjedisin online, infrastruktura paraqitet mëse e plotësuar ku gjenden shumë websajte që i kushtohen mësimit të fesë Islame sipas interpretimit të kësaj shkollë apo të shkollave të tjera të përafërta. Për të kuptuar më mirë mesazhet që përcjellin këto websajte, mjafton të lexohet shkrimi me titull “Allahu e shpërbleftë Mbretërinë e Arabisë Saudite me më të mirin shpërblim, për zbatimin e ndëshkimit sheriatik ndaj cilitdo që e meriton atë”<sup>66</sup>, ku bëhet fjalë për ndëshkimin e dhënë para pak ditësh ndaj disa klerikëve në Arabinë Saudite.

Në disa websajte fetare islamike gjenden edhe shkrime ku kërkohet që ekstremizmi të mos shihet si ekskluzivitet i salafistëve dhe të bëhet diferencimi mes salafizmit dhe tekfirizmit. Në shkrimin “Mos fajësoni selefijtë për ISIS-in”, autori argumenton se ideologjia që frymëzon ISIS-in nuk është salafizmi por tekfirizmi. “Një nga çështjet që na ndihmon të kuptojmë këtë dhunë

---

<sup>65</sup> *Religious fundamentalism and radicalisation*, Parlamenti European, European Parliamentary Research Service, Autore: Anita Orav, Mars 2015, f.3

<sup>66</sup> Link: <http://www.selefi.org/index.php/aktualitet/1904-allahu-e-shperblefte-mbreterine-e-arabise-saudite-me-me-te-mirin-shperblim-per-zbatimin-e-ndeshkimit-sheriatik-ndaj-cilitdo-qe-e-meriton-ate>, aksesuar më 04.01.2016.

është ideologjia e *Tekfirizmit*; ose akti i përjashtimit të myslimanëve të tjerë; deklarimi i tyre si të dalë nga Islami. Kjo praktikë e rrezikshme u jep mundësi atyre të sulmojnë myslimanët e tjerë pa asnjë problem. Pavarësisht se disa selefijë, bashkëkohorë apo më të hershëm, mund të kenë përdorur *tekfirin*, ky nuk është një problem ekskluzivisht vetëm i selefijve.”<sup>67</sup>

Në një koment tjetër për shkrimin “Xhihadizmi: një revoltë gjeneracionale dhe nihiliste”, nënvizohet: “Ngatërimi i Selefizmit me Tekfirizmin është po aq i rrezikshëm sa ngatërimi i Islamit me terrorizmin. Të gjitha karakteristikat që ka përmendur autori i përshtaten më së miri personave me ide tekfiriste, ose e shumta atyre që e quajnë veten “selefijtë xhihadistë”, të cilët në fakt janë më shumë tekfirista se selefij.”<sup>68</sup>

Gjithsesi, pavarësisht nga një lloj kujdesi për ta veçuar salafizmin nga ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, termat e tjerë të diskursit në websajtet fetare të këtyre rrymave të reja janë tipike fundamentaliste, ku dallohet mes të tjerash edhe intoleranca ndaj “jobesimtarëve”, term i cili në kuptimin salafist përfshin edhe besimtarët e feve të tjera. Si shembull mund të sjellim shkrimin “Imani dhe Kufri” të botuar në një websajt fetar në të cilin thuhet:

“Kufri (mosbesimi – shënim i autorit) nuk përbëhet vetëm nga mohimi i parimeve themelore të akides. Ka disa vepra, të cilat nëse kryhen bëhet kufër. Ato mund të përmbliidhen në një shprehje: “Adhurimi i të tjerëve përveç Allahut.” Adhurimi është e drejtë vetëm e Allahut

---

<sup>67</sup> <http://observer.al/mos-fajesoni-selefijte-per-isis-in/>

<sup>68</sup> <http://www.e-zani.com/2015/11/25/xhihadizmi-nje-re-volte-gjeneracionale-dhe-nihiliste/>

dhe drejtimi i adhurimit për ndokënd ose diçka tjetër përveç Allahut është shirk (politeizëm), siç është shirk falja (përrulja) ndaj dikujt tjetër përveç Allahut, lutja ndaj dikujt tjetër përveç Allahut. Njeriu mund të bëhet kafir (jobesimtar) duke thënë fjalë ofenduese për Krijuesin, të Lavdëruarin dhe të Lartësuarin ose për Islamin, për pejgamberët ose thënia e fjalëve tallëse për Islam in ose fjalëve përkrahëse për ideologjitë e gabuara siç janë Judaizmi dhe Krishterimi ose paditja e Islamit për papërsosuri, prapambeturi etj.”<sup>69</sup>

Lidhur me qëndrimin që duhet mbajtur ndaj jobesimtarëve, autori shprehet: “Myslimani duhet t’i konsiderojë jobesimtarët si armiq dhe duhet t’i urrejë për shkak të kufrit të tyre, ashtu siç e urren kufirin (mosbesimin) e tyre.”

Në një optikë përjashtuese dhe mohuese ndaj feve të tjera autori i një shkrimi tjetër me titull “Për miqët e mi të krishterë!”, shkruan: “Është koha që t’i thirrni mendjes suaj, se kë po adhuroni. Besimi juaj se Jezusi është ‘Zot’, bie në kundërshtim me mësimet e biblës. ...Sot bibla nuk është më fjalë e Zotit, porse një shkrim i shkruar nga mendja dhe imagjinata e njeriut.”<sup>70</sup>

Në një vlerësim të përgjithshëm mund të themi se mediat fetare online në gjuhën shqipe që frymëzohen nga salafizmi dhe nga rryma të tjera ekstremiste karakterizohen nga një platformë radikalizuese, e cila përmban të gjitha termat e fundamentalizmit fetar, të cilat mund të përmbliidhen në këto kërkesa:

---

<sup>69</sup> *Imani dhe Kufri*, Link: <http://www.tezkije.com/artikulli/95>

<sup>70</sup> *Për miqët e mi të krishterë!*, Link: <http://radio-pendimi.com/web-faqe/per-miqet-e-mi-te-krishtere/>

- Besimtarët duhet të kthehen mbrapa te rregullat absolute dhe të pandryshueshme të themeluara në të shkuarën
- Këto rregulla lejojnë vetëm një interpretim në mesin e besimtarëve, dhe
- Rregullat fetare duhet të mbizotërojnë mbi ato sekulare<sup>71</sup>

Bëjmë të qartë se këto terma nuk janë unike vetëm për fundamentalizmin islamik, madje termi fundamentalizëm fetar në origjinë është përdorur për lëvizjen ringjallëse Protestane në fillim të viteve 1900 në SHBA, dhe i referohet edhe lëvizjeve të ngjashme brenda Kristianizmit, Judaizmit dhe Hinduizmit.<sup>72</sup> Por duke qenë se këto forma të tjera të fundamentalizmit në Shqipëri janë inekzistente ose gati inekzistente, vëmendja kryesore sot përqendrohet te fundamentalizmi islamist, tashmë i pranishëm dhe jo pak problematik për realitetin shqiptar.

### ***Sheriati apo shteti ligjor i demokracisë liberale? Kalifati në horizont...***

Sheriat në vend të shtetit ligjor? E besojmë apo jo, ky debat në Shqipëri është duke ndodhur. Edhe pse është periferik dhe i izoluar, ai pasqyron thellësinë e depërtimit të doktrineve islamiste në ato segmente të shoqërisë që

---

<sup>71</sup> *Religious fundamentalism and radicalisation*, Parlamenti European, European Parliamentary Research Service, Autore: Anita Orav, Mars 2015, f.3

<sup>72</sup> Koopmans, Ruud, *Religious fundamentalism and hostility against out-groups: a comparison of Muslims and Christians in Western Europe*, në *Journal of Ethnic and Migration Studies* 41:1, 2014, f. 33-57

janë të prekura prej tyre si dhe ndikimin e propagandës së ISIS në vend. Debatu paraqitet si në plan teorik, politik apo ideologjik, të zhvilluar kryesisht në websajtet fetare online, edhe në plan konkret, si devizë apo pjesë e kredos dhe e veprimit praktik të islamistëve shqiptarë të lidhur me ekstremizmin e dhunshëm.

Doktrinat islamiste janë të njohura për anti-sekularizmin e tyre dhe për refuzimin e demokracisë liberale dhe të shtetit ligjor. Ato promovojnë struktura shtetformuese të bazuara dhe të kufizuara nga feja, ku në vend të ligjit vepron tërësia e rregullave fetare e njohur ndryshe si Sheriati.

Në shkrimin me titull "A lejohet studimi i drejtimit të juridikut për një besimtar mysliman?" theksohet se "një nga shtyllat thelbësore të besimit të myslimanit është: besimi se vetëm Allahut i takon gjykimi absolut dhe vetëm Ai është i denjë si ligjvënës (El Hakimije). Zoti i Madhërishëm në Kuranin fisnik thotë: "*Vendimi (gjykimi) i takon vetëm Allahut. Ai e shpall të vërtetën dhe Ai është Gjykatësi më i mirë*". (Enam, 57) Përderisa në drejtimin e juridikut mësohen ligjet të cilat i kanë vendosur njerëzit dhe janë në kundërshtim me ato që janë zbritur nga Zoti i Madhërishëm, atëherë me mësimin e këtyre njohurive, besimtari ballafaqohet me sprovën që të pajtohet me to, ose të punojë me to duke lënë anash ligjet e Zotit, ose t'u japë përparësi atyre ligjeve në llogari të ligjeve të Zotit dhe nuk ka dyshim se të gjitha këto, mund të shpien muslimanin në kufër (mosbesim)."<sup>73</sup>

---

<sup>73</sup> A lejohet studimi i drejtimit të juridikut për një besimtar musliman? Link: <http://radio-pendimi.com/webfaqe/a-lejohet-studimi-i-drejtimite-juridikut-per-nje-besimtar-musliman/>

Në një plan më të përgjithshëm diskursi islamist propagandon “fundin e shtetit-komb dhe të demokracisë liberale” apo “kriazën e modernizmit”<sup>74</sup> nga njëra anë dhe “lindjen e një qytetërimi të ri islamik”<sup>75</sup> nga ana tjetër. Në shkrimin “Rezonanca e islamit dhe rilindja e ditëve të “pushtimit” kulturor” aludohet se “mbaruan ditët e pushtimit të idesë për superioritetin e demokracisë liberale dhe imunitetin e saj nga sfidat e sistemeve tjera.”<sup>76</sup> Kurse në shkrimin tjetër “Rigjallërimi Islam: Një perspektivë perëndimore e problemit”, flitet për “një identitet islam në rritje universale”, apo për “Identitet Global Mysliman” dhe rigjallërimi i Islamit shihet si një “këmbim vendesh me qasjen perëndimuese, e zakonshme kjo në qeveritë në fillimet e shekullit XX.”<sup>77</sup> “Rrethanat moderne e çliruan lavjerrësin e kësaj luhatjeje të paqëndrueshme dhe e shtynë qendrën e rëndesës, përfundimisht dhe përgjithmonë, larg llojit pluralist, hierarkik, organizativ, durkheim-ian dhe drejt Islamit të lartë.”<sup>78</sup> - thuhet në një shkrim tjetër.

Në terma më specifike, në disa websajte fetare islamiste shprehet refuzimi ndaj vlerave të demokracisë

---

<sup>74</sup> <http://www.profetimuhamed.info/islami-dhe-kriza-e-modernizmit/>

<sup>75</sup> <http://www.mediaelire.net/lajm/4018/bota-musli-mane-duhet-te-shkoje-drejt-krijimit-te-qyteterimit-te-ri-islamik/>

<sup>76</sup> *Rezonanca e islamit dhe rilindja e ditëve të “pushtimit” kulturor*, Link: <http://www.rtvbesa.com/rezonanca-e-islamit-dhe-rilindja-e-diteve-te-pushtimit-kulturor/>

<sup>77</sup> *Rigjallërimi Islam: Një perspektivë perëndimore e problemit*, Link: <http://www.e-zani.com/2015/10/21/rigjallerimi-islam-nje-per-spektive-perendimore-e-problemit/>

<sup>78</sup> [http://www.xhemailcupi.com/index.php?option=com\\_content&view=article&id=127:ese-feja-dhe-profania&catid=5:histori-a-diplomaci&Itemid=6](http://www.xhemailcupi.com/index.php?option=com_content&view=article&id=127:ese-feja-dhe-profania&catid=5:histori-a-diplomaci&Itemid=6)



perëndimore, siç është për shembull liria e fjalës apo të drejtat e njeriut. “Myslimanët nuk besojnë në konceptin e lirisë së shprehjes, se të folurit dhe veprimet e tyre janë të vendosur me anë të zbulësës hyjnore dhe jo në bazë të dëshirave të njerëzve”<sup>79</sup> – deklaron në media një përfaqësues i klerit mysliman.

Në debatin për të drejtat e njeriut, islamistët refuzojnë si njohjen e të drejtave universale të njeriut edhe parimin e të drejtave të barabarta për të gjithë, veçanërisht për gratë. Është i njohur fakti se në Shqipëri, gruaja gëzon një numër të drejtash dhe në shumë plane ajo nuk dallohet nga gratë në shoqëritë perëndimore. Por vitet e fundit, edhe pse në një masë shumë të vogël, janë shfaqur raste të kufizimit të aktivitetit të gruas vetëm brenda punëve të shtëpisë ose raste të përjashtimit të saj nga aktivitetet publike. Një ndikim për këtë ka patur edhe propagandimi dhe imponimi nga ana e pjesëtarëve meshkuj të familjes i mënyrës së jetesës sipas konceptit konservator salafist.

Në shkrimin “Punësimi i femrës sipas pikëpamjes së Sheriatit Islam” paraqitet i gjithë kodi i rregullave të Sheriatit për angazhimin me punë të gruas, edhe pse ky kod bie në kundërshtim me kushtetutën dhe me ligjet e tjera dhe nuk ka sens të propozohet në një realitet si Shqipëria. Ky kod vjen në këtë mënyrë si alternativë zëvendësuese ndaj ligjit dhe si sfidë për vetë shoqërinë liberal-demokratike dhe për pozicionimin e saj ndaj gruas. Përveç kufizimeve në raport me punën, kodi paraqet edhe kufizime të tjera për femrën, për shembull:

---

<sup>79</sup> <http://www.zeri.info/aktuale/14248/kleriku-mysliman-mysli-manet-nuk-besojne-ne-lirine-e-te-shprehurit/>

“Të mos ketë përzierje dhe vetmi me meshkujt e huaj, ngase kjo përzierje ndikon negativisht në aspektin e moralit. Kjo është kështu ngase i Dërguari s.a.w.s. ka tërhequr vërejtjen duke thënë: “Të mos vetmohet mashkulli me një femër të huaj ngase shejtani është i treti në mesin e tyre”.

Të mos shpalosë bukuritë e saj. Nga kjo kuptohet që femra, e cila është e angazhuar, duhet të ruhet që të mos i zbulojë bukuritë e saj dhe që të mos jetë nxitëse e të tjerëve. Të jetë e stolitur me devotshmëri ndaj Allahut të Lartësuar, ngase kur kjo është e devotshme e ruan vetën prej të këqijave dhe nuk nxit të tjerët kah e keqja.

Të jetë e veshur me mbulesën islame, duke mos shpalosur para të huajve veç atë që është e lejuar. “Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit se kjo është më e pastër për ta. Allahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.”<sup>80</sup>

Në kundërvënienë të hapur dhe të plotë me konceptin e lirisë dhe të drejtave të njeriut që ekziston në shoqëritë perëndimore, paraqitet edhe trajtimi i grupeve të marginalizuara si ato LGBT nga ana e analistëve të websajteve islamiste. Kështu në shkrimin “Çfarë gjykimi kanë homoseksualët në Islam”, ofrohet një qasje ekstremiste e dhunshme ndaj problemit. “Dijetarët kanë rënë në mospajtime rreth ndëshkimit të homoseksualit. Mendimi më i saktë është se ai vritet, çfarëdo vrasje qoftë ajo, vritet ai që është aktiv dhe pasiv, në qoftë se të dy e kanë bërë me epsh (e jo me dhunë, sh.p.) dhe ndëshkohet

---

<sup>80</sup> [http://www.unioni.at/uebi/index.php?option=com\\_content&view=article&id=150:punesimi-i-femres-sip-as-pikepamjes-se-sheriatit-islam&catid=1:latest-news](http://www.unioni.at/uebi/index.php?option=com_content&view=article&id=150:punesimi-i-femres-sip-as-pikepamjes-se-sheriatit-islam&catid=1:latest-news)

ai që nuk ka arritur pubertet. Pastaj, vetë homoseksuali sprovohet me sëmundje që nuk kanë shërim, siç ka ndodhur në Amerikë me sëmundjen e Sidës (HIV).<sup>81</sup>

Siç e thamë edhe më sipër, krahas debatit në plan teorik politik apo ideologjik, Sheriati paraqitet edhe si devizë apo pjesë e kredos dhe e veprimit të islamistëve shqiptarë të lidhur me ekstremizmin e dhunshëm. Kështu, një nga të arrestuarit e akuzuar për rekrutim në shërbim të ISIS, refuzon të gjykohet prej ligjeve të shtetit shqiptar dhe preferon të gjykohet vetëm nga ligjet e Allahut<sup>82</sup>.

Duke refuzuar plotësisht modelin e shtetit ligjor dhe të demokracisë liberale, ekstremistët islamistë propozojnë si alternativë Kalifatin. Në një intervistë në media, një personazh tjetër i akuzuar për lidhje me ISIS, deklaroi: “Kalifati është një vend i mirë për të jetuar nëse je besimtar mysliman.”<sup>83</sup> Në të njëjtën linjë deklarohet edhe imami i njëjës prej xhamive në Tiranë që është jashtë kontrollit të KMSH: “Çdo myslimani të vërtetë i pëlqen të jetojë aty ku gjykohet me ligjin Islam. Çdo mysliman i sinqertë do të donte të jetonte me ligjin islamik në Kalifat”<sup>84</sup> – thotë ai.

---

<sup>82</sup> <http://www.selefi.org/index.php/te-ndryshme/1620-cfare-gjy-kimi-kane-homoseksualet-ne-islam-shejkh-mukbil>

<sup>82</sup> Rekrutuesit e xhihadistëve refuzojnë Gjykatën: Duam të gjykohemi me ligjet e Allahut, <http://www.lapsi.al/lajme/2015/03/24/rekrutuesit-e-xhihadist%C3%ABve-refuzojn%C3%AB-gjykat%C3%ABn-duam-t%C3%AB-gjykohemi-me-ligjet-e-allahut#.VoqEgfkKM8>

<sup>83</sup> <http://www.reporter.al/toleranca-ne-prove-shqiperia-perballe-sfides-se-radikalizmit/>

<sup>84</sup> *Imami i xhamisë së “Unazës së Re”: Francezët s’janë më të mirë se Lavdrim Muhaxheri* Gazeta Tema, 21 Nëntor 2015

Në mediat islamiste online alternativa e Kalifatit nuk paraqitet vetëm si një dëshirë apo ëndërr e besimtarit të devotshëm mysliman; ajo artikulohet edhe si një projekt politik global që ka si qëllim final ndërtimin e të ashtuquajturit “shtet i fundit”, apo “shtet i drejtësisë hyjnore”. Në një shkrim të një autori të huaj të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të botuar në mediat online thuhet se “bashkësia muslimane nuk e ka përmbushur pikësynimin e saj të fundit: Ndërtimin e Shtetit të Drejtësisë Hyjnore!”. Por, “Sipas një hadithi të shënuar, nga burimet shiite, Imam Xhafer Sadiku (a.s.) ka thënë se: “Shteti i ndërtuar nga Imam Mehdiu (a.s.), do të jetë shteti i fundit në sipërfaqen e tokës!” Bashkësia muslimane beson se, Imam Mehdiu do të ndërtojë shtetin e drejtësisë hyjnore, nën udhëheqjen e të cilit do të bashkohen, të tërë shoqëritë dhe popujt e botës nën një flamur të vetëm.”<sup>85</sup>

Teza të tilla të Islamit Politik, nuk kanë qenë artikuluar ndonjëherë në gjuhën shqipe dhe nuk i janë servirur si alternativë shqiptarëve gjatë gjithë ekzistencës së Islamit tradicional. Por rrymat e reja ekstremiste po i mbjellin ditaditës këto teza, dhe deklarinimet e mësipërme të simpatisë së disa ekstremistëve shqiptarë për Kalifatin janë tregues i faktit se fara e huaj e mbjellë gjatë këtyre dy dekadave të fundit ka çelur filizat e vetë edhe në një truall europian si Shqipëria. Shpalosja e këtyre tezave në kontekstet aktuale të luftës së ISIS e cila frymëzohet pikërisht nga ideja e krijimit të një shteti të drejtësisë hyjnore, është tepër e rrezikshme dhe një kërcënim serioz për shoqërinë shqiptare dhe të ardhmen europiane të saj.

---

<sup>85</sup> <http://www.mediaelire.net/lajm/4059/shteti-i-kurdistanit-esh-te-pjese-e-shtetit-te-fundit/>

## ***Diskursi antiperëndimor e antiamerikan dhe teza e standardeve të dyfishta***

Diskursi ekstremist antiperëndimor dhe antiamerikan është i pranishëm jo vetëm në mediat online, por edhe në shtyp. Ai ndjek disa forma, mes të cilave forma më e përdorur është ai lloj diskursi që shtron pyetjen: “Kush e shkakton terrorizmin” dhe që në përgjigje e gjen shkakun në anën e Perëndimit dhe të SHBA. Më së shumti, në këtë lloj diskursi fajësohen ndërhyrjet ushtarake të Perëndimit në Lindjen e Mesme dhe Afganistan si dhe politika e ndjekur nga ana e Perëndimit ndaj këtyre vendeve. Një shpërthim i këtij lloj diskursi u vu re sidomos pas akteve terroriste në Paris, nëntor 2015.

Në shkrimin me titull “Vajtojmë viktimat e Parisit: shkaku janë luftërat tona, jo Islami”, duke cituar një gazetar gjerman që u lejua të hynte brenda territoreve të ISIS, thuhet: “Nuk është Islami arsyeja e terrorit ISIS, por luftërat e Perëndimit. Mbi të gjitha, lufta e Irakut e George Bush-it, i cili që nga tetori i vitit 2003 drejtonte themelimin e ISIS-it.”<sup>86</sup> Bie në sy në këtë rast përpjekja për të krijuar një kundërvënie Perëndim/Islam dhe për të gjetur palën fajtoare në këtë kundërvënie.

I njëjti gazetar perëndimor, në një websajt tjetër fetar, citohet të ketë thënë: “Në botë ka 45 shtete myslimane. Asnjëri prej tyre në 200 vitet e fundit nuk ka sulmuar ndonjë shtet perëndimor. Ne ishim gjithmonë ata që sulmuam ushtarakisht. Luftërat e përgjakshme të

---

<sup>86</sup> *Vajtojmë viktimat e Parisit: shkaku janë luftërat tona, jo Islami*,  
Link: <http://www.asabija.com/vajtojme-viktimat-e-parisit-shka-ku-jane-lufterat-tona-jo-islami/>

kryqëzatatave, kolonizimi, lufta e Parë dhe e Dytë botërore, shfarsojet e tmerrshme masive të komunisteve kinezë dhe sovjetikë, holokausti i hebrenjve në Europë – të gjitha këto krime nuk i kanë bërë myslimanët.”<sup>87</sup>

Në një analizë të botuar në një nga gazetatat e përditshme shqiptare deklarohet se “Janë qeveritë e këtyre vendeve që çelën kutinë e Pandorës me Sirinë, me politikat gjeonaftëtare në Gjirin Persik, dhe me vëzhgimin e ftohtë të ISIS-it, ndaj ata (terroristët – shënim i autorit) zgjodhën pikërisht spektatorët e një koncerti rock në Bataclan dhe larguan nga kjo jetë të paktën 100 të rinj.”<sup>88</sup>

Për të përforcuar diskursin e tyre antiperëndimor dhe antiamerikan disa websajte fetare nuk rreshtin së përkthyeri edhe artikuj apo fjalime të autorëve apo liderëve nga Lindja e Mesme. Kështu në këto websajte u përkthye dhe u botua një thirrje e liderit suprem të Iranit Ajatullah Khamenei drejtuar të rinjve në vendet perëndimore pas akteve terroriste të nëntorit në Paris.

“Sot, janë të paktë njerëzit që janë të informuar për rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në themelimin, furnizimin dhe armatosjen e Al Kaidës, talebanëve dhe pasuesve të kobshëm.” – thuhet në këtë thirrje – “Përveç kësaj përkrahje direkte, përkrahësit e hapur e të njohur të terrorizmit takfiristë, megjithëse kanë sistemet politike më të prapambetura, gjithmonë janë radhitur në mesin e aleatëve të Perëndimit, në një kohë që idetë më të ndritura e më përparimtare që rrjedhin nga demokracitë

---

<sup>87</sup> <http://islamifejaevvertete.com/jurgen-todenhofer-ne-bote-ka-45-shtete-muslimane-asnjeri-prej-tyre-ne-200-vitet-e-fundit-nuk-ka-sulmuar-ndonje-shtet-perendimor-burimi-www-islamifejaevvertete-com>

<sup>88</sup> *Në syrin e mortjes*, Gazeta Tema, 15 Nëntor 2015

përparimtare në rajon, janë shtypur në mënyrë të pamëshirshme. Qëndrimi dyfytyrësh i Perëndimit ndaj valës së zgjimit në Botën Islame është një shembull i qartë i kundërthënive në politikat perëndimore. Kjo kundërthënie vërehet qartë edhe në përkrahjen e Perëndimit për terrorizmin shtetëror të Izraelit.”<sup>89</sup>

Në disa shkrime të tjera, vërehet një diskurs i përgjithshëm antiluftë, për shembull shkrimi “Jo luftës, me luftë!” që shtron pyetjet: “A zgjidhet lufta me luftë? A zgjidhet terrori me terror?” – dhe që në thelb është kundër ndërhyrjes ushtarake të Perëndimit në konfliktin e krijuar nga ISIS.

Siç del edhe nga monitorimi i kryer, shumica e diskursit antiperëndimor dhe antiamerikan gjenden në websajtet e fesë Islame dhe në disa raste vihet edhe në shërbim të diskursit islamist. Kështu, në shkrimin me titull “Rezonanca e Islamit dhe rilindja e ditëve të “pushtimit” kulturor”, pasi renditen një numër i madh akuzash tipike islamiste ndaj Perëndimit, arrihet në përfundimin se këto akuza “demontojnë tezën për superioritetin e liberal demokracisë dhe e legjitimojnë çdo ditë e më tepër thirrjen për një sistem të drejtë, një rilindje të vërtetë kulturore, edhe nëse quhet nga të tjerët si pushtim, që do t’i evitonte këto diskrepanca dhe çarje serioze prezente në të gjitha fushat. Kjo dhe çdo ditë e më tepër shihet si një qasje pozitive e banorëve perëndimorë ndaj Islamit dhe çështjeve që lidhen me muslimanët.”<sup>90</sup>

---

<sup>89</sup> <http://www.mediaelire.net/lajm/3838/letra-e-dyte-e-ajetullah-hamenei-drejtuar-te-rinjve-ne-vendet-perendimore-imam-hamenei-shkruan-leter-te-re-per-rinine-e-perendimit/>

<sup>90</sup> *Rezonanca e Islamit dhe rilindja e ditëve të “pushtimit” kulturor*, Link <http://www.rtvbesa.com/rezonanca-e-islamit-dhe-rilindja-e-diteve-te-pushtimit-kulturor/>

Një grup tjetër shkrimesh në kuadër të diskursit antiperëndimor janë ato shkrime që botojnë apo trajtojnë supozime dhe teori konspiracioni lidhur me aktet terroriste apo me krijimin e ISIS. Një prej shkrimeve të tilla i referohet sërish një perëndimori, dhe konkretisht analistit politik nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës Pol Krejg Roberts, i cili citohet të ketë thënë se “sulmi në Paris ku jetën e humbën mbi 100 qytetarë francezë ishte një operacion i mirëorganizuar nga shërbimet e specializuara sekrete të shtetit francez dhe se ky aksion nuk ka patur asnjë lidhje me terrorizmin nga shtetet islamike.”<sup>91</sup>

Në një shkrim të botuar në një gazetë të përditshme me titull sensacional “Zbulohet! Ja kush fshihet prapa ISIS-it” thuhet se: ““Al Jazeera” nëpërmjet gazetes britanike “Daily Mail” publikoi lajmin se Instituti Mediatik Amerikan ka arritur të aksesojë një kopje të një dokumenti sekret i cili vërteton se pas shtetit Islamik të Shamit dhe Irakut (ISIS) qëndrojnë agjenturat izraelite.”

Ndërsa në një gazetë tjetër, autori thellohet edhe më tej në retorikën e tij të konspiracionit:

“Edhe pse u bë dhe vazhdon të bëhet një propagandë intensive paragjykuese e manipuluese, me shumë gjasa ISIS është më tepër “krijesë laboratorësh” sekrete shumëkombëshe sesa të një “shtatzënie normale” të vetë fesë islame. Përgjithësisht aksionet terroriste të ISIS-it, sidomos ato në Londër, Paris, Tuniz (18 mars 2015), Bejrut etj., kanë treguar se kemi të bëjmë me skenarë të përgatitur nga “regjisorë” dhe “aktorë” me përvojë. Vetvetiu lind pyetja: Ku e mësuan dhe përvetësuan artin e terrorit?”

---

<sup>91</sup> *Sulmin në Paris e kryen shërbimet sekrete franceze*, Link: <http://www.mediaelire.net/lajm/3785/sulmin-ne-paris-e-kryen-sherbi-met-sekrete-franceze/>



Në shkollat e shkretëtirave apo të xhamive? Nga imamë arabo-lindorë, përgjithësisht me mjekra, por pa tituj dhe pa punë intelektuale apo nga “profesorë” dhe instruktorë izraelitë, turq, arabë, amerikano-perëndimorë, britanikë etj., me bollëk “veprash”, në fushën e shërbimeve sekrete, të operacioneve ushtarake, terroriste e antiterroriste, për eliminime individësh të rrezikshëm apo që dinin sekrete, që duhej t’i merrnin në varre, për rrëzime diktatorësh dhe regjimesh?”<sup>92</sup>

Dihet se prania në axhendën e medias e qasjeve konspirative nuk ndihmon në një informim të saktë të lexuesit, përkundrazi krijon edhe më shumë pështjellim tek ai, siç ka ndodhur edhe në rastin e shkrimeve të mësipërme, të cilat shpesh janë me burime të dyshimta apo të sajuara. Përveç kësaj qasje të tilla, ashtu si edhe i gjithë diskursi i mësipërm, mund të vihen edhe në shërbim të nxitjes së urrejtjes antiperëndimore, antisemite apo antiamerikane.

Një tezë tjetër e ndeshur shpesh në diskursin ekstremist antiperëndimor është teza e standardeve të dyfishta. Sipas kësaj teze, shoqëritë dhe mediat perëndimore trajtojnë me standarde të dyfishta aktet terroriste që kryhen në Europë dhe ato që kryhen në Lindjen e Mesme apo në vende të tjera joperëndimore të botës dhe “pikërisht ky standard i dyfishtë po e shkatërron botën.”<sup>93</sup> Brenda të njëjtës tezë flitet për “solidaritet hipokrit” në rastin e solidaritetit me Francën<sup>94</sup> e madje shtrohen edhe pyetje

---

<sup>92</sup> *ISIS, “shejtani” që ka dalë nga shishja*, Gazeta Shqip, 20 Nëntor 2015

<sup>93</sup> <http://www.e-zani.com/2015/11/27/post-paris/>

<sup>94</sup> Sulmet në Francë dhe solidariteti ynë hipokrit, Link:[http://www.lapsi.al/ide/2015/11/16/sulmet-n%C3%AB-franc%C3%AB-dhe-solidariteti-yn%C3%AB-hipokrit#.Vm\\_ZsflViko](http://www.lapsi.al/ide/2015/11/16/sulmet-n%C3%AB-franc%C3%AB-dhe-solidariteti-yn%C3%AB-hipokrit#.Vm_ZsflViko)

të tilla si “Pse vrasësit konsiderohen terroristë vetëm kur janë myslimanë?”, etj.

Në shkrimin e një autori perëndimor me titull “Tragjedia e Parisit nxori në pah racizmin tonë të fshehur”, dhe të përkthyer nga një websajt fetar, shkruhet: “Ne vajtojmë vdekjet në Paris, por i kalojmë pa i vënë re ata që u vranë në Liban një ditë më parë, e me siguri nga të njëjtët fanatikë që ndërmorën sulmet në Paris.”<sup>95</sup>

Për standard të dyfishtë akuzohet edhe media: “Si gjithmonë, mbulimi mediatik i kësaj ngjarjeje (i akteve terroriste në Paris - shënim i autorit) ka qenë në shpërpjesëtim, duke lënë mënjanë sulmet terroriste në Liban nga të njëjtët terroristë, të cilët vranë rreth 50 vetë dhe plagosën 250 të tjerë në kryeqytetin e Libanit, Bejrut.”

Ndërkohë në disa nga mediat kryesore ofrohet një qasje tjetër opozitare ndaj tezës së standardeve të dyfishta. “Të gjithë ata që tentojnë ta relativizojnë këtë rrezik (rrezikun e Islamit politik – shënim i autorit), të bëjnë interesantin, duke theksuar gabimet e perëndimit, të bëjnë paralele pa lidhje mes akteve terroriste, mes fraksioneve terroriste, mes Bejrutit apo Damaskut dhe asaj që ndodhi në Paris, apo të tjerë që pafuqinë apo apatinë e tyre ndaj qeverive të korruptuara në rajon, bëjnë sikur ua mbush terrori i ISIS, janë realisht aleatët e rrezikshëm të kësaj ideologjie.”<sup>96</sup> – thuhet në një shkrim të gazetës *Tema*.

Një reagim ndaj tezës së standardeve të dyfishta është botuar edhe në gazetën *Panorama*: “Me mesazhet

---

<sup>95</sup> <http://observer.al/tragjedia-e-parisit-nxori-ne-pah-racizmin-tone-te-fshehur/>

<sup>96</sup> *Parisin duhet ta mbrojmë në Tiranë*, Gazeta Tema 15 Nëntor 2015

e pafundme të solidaritetit nuk ishin të pakta as pyetjet retorike: “Përse nuk shprehet i njëjti solidaritet me viktimat në Francë dhe me ato në Siri apo Irak?” Kjo retorikë vetëm sa thëllon alarmin e situatës. Kushdo që vë në dyshim dhe akuzon përse nuk ka solidaritet me çdo jetë të humbur në Siri, në fakt është vënë në pritë të momentit për t’u hakërryer. ... Kushdo që ngre pseudoçështjen e mosbarazisë së vlerës së jetës njerëzore në Paris dhe në Bagdad, në fakt kërkon hakmarrje. ... Kushdo që po aludon se masakra e Parisit është një kthim përgjigjeje i asaj çka po ndodh në Siri, po e barazon popullin sirian me një organizatë terroriste.”<sup>97</sup>

### ***In extremis – Përlligjja, glorifikimi dhe promovimi i dhunës ekstreme***

Krahas diskursit teorik të moderuar apo që shkon deri në zgrip, në mjedisin online në gjuhën shqipe shfaqet herë pas here edhe diskursi që përlligj, glorifikon dhe promovon dhunën ekstreme, qoftë kjo e drejtuar ndaj trupave militare apo ndaj grupeve e komuniteteve të ndryshme jomilitare. Ky diskurs, i shfaqur veçanërisht në vitet e fundit, edhe pse paraqitet i rrallë dhe i izoluar, rezonon shpesh me dhunën në kontekstet aktuale, siç është ajo që zhvillohet nga ISIS.

Burime të këtij diskursi kanë qenë kryesisht disa media online ose seksione të tyre të kontrolluara nga ISIS apo nga grupe të tjera ekstremiste islamiste. Por shfaqje të diskursit në formën e denoncimit të tij vihen re edhe në raportimet e mediave për raste të ligjërimeve ekstremiste të dhunshme nga ana e individëve islamistë apo ekstremistë.

---

<sup>97</sup> *Encore La France*, Gazeta Panorama, 17 Nëntor 2015

Në disa prej materialeve të dhunshme ekstreme, është ndeshur një përligje apo promovim i dhunës ndaj trupave militare të konsideruara armike. Kështu gjatë një interviste në media, një person i dyshuar për lidhje me ISIS, përligj ekzekutimin e pilotit të forcave ajrore jordaneze, i cili u dogj i gjallë brenda një kafazi në fillim të vitit 2015, duke shtuar më tej se piloti “nuk ishte duke hedhur karamelle”<sup>98</sup>. Në një material tjetër të raportuar nga mediat, flitet për një thirrje të ISIS dhe të al-Nusra për të ndezur xhihad në Rusi. “Nëse ushtria ruse vret njerëz të Sirisë, atëherë vrisni njerëzit e saj. Nëse ata vrasin ushtarët tanë, ju vrisni ushtarët e tyre”<sup>99</sup> - thuhet në këtë thirrje.

Në këtë lloj diskursi ka raste kur përfshihen edhe predikues të fesë Islame në Shqipëri. Njëri prej këtyre përligj edhe prerjen e kokave si ndëshkim i zbatuar nga ISIS: “Krimet më të mëdha në Siri i ka bërë Assadi dhe pas Assadit i ka bërë koalicioni anti-ISIS që shumicën e bombave e hedhin mbi popullin. Ajo koka në dorën e Lavdërim Muhaxherit, më kujtoi një pullë postare franceze me kokat e algjerianëve të prera”<sup>100</sup>- thotë ai në një intervistë për mediat.

Në një material tjetër shprehet edhe simpatia për të rënë në “luftën e shenjtë” të ISIS. “Lajm i bukur ishte që nëna e Diamantit, falënderoi Zotin që djali i saj ra shehid. Kisha respekt dhe për babain e tij, se ishte krenar për vdekjen e djalit të tij. Kisha kënaqësi ta takoja atë njeri

---

<sup>98</sup> <http://www.reporter.al/toleranca-ne-prove-shqiperia-perbal-le-sfides-se-radikalizmit/>

<sup>99</sup> *IS-I, al-Nusra: Ndizni “xhihad” në Rusi!* Gazeta Tema, 16 Tetor 2015

<sup>100</sup> *Imami i xhamisë së “Unazës së Re”: Francezët s’janë më të mirë se Lavdrim Muhaxheri* Gazeta Tema, 21 Nëntor 2015

të veçantë”<sup>101</sup>- thotë gjatë procesit gjyqësor një nga të akuzuarit për rekrutime në shërbim të ISIS.

Mediat raportojnë edhe për një video të një imami ekstremist nga Lindja e Mesme i cili bën thirrje për vrasje të hebrenjve në emër të Allahut.” Goditini në qafë me thikë... Nuk jeni ju që i vrisni: është Allahu që po i godet”, bën thirrje Imami. Ai madje sjell shembullin e Muhamedit që në vitin 627, në portat e Medinës, mori pjesë personalisht në therjen e 800 hebrenjve. Sipas tij, “në dhjetorin e 1987 nisi ajo që u quajt “Intifada e parë” dhe nisën sulmet me gurë. Intifada e dytë nisi në shtator të 2000 me sulmet me kallashnikov. Intifada e tretë e cila sapo ka nisur është ajo e thikës, ku besimtarët myslimanë ftohen të godasin me thikë hebrenjtë.”<sup>102</sup>

Me shumë zemërim dhe shqetësim janë pritur në opinionin publik shqiptar edhe disa video të prodhuara nga ISIS në të cilat xhihadistë nga Shqipëria apo Kosova që janë pjesë e trupave aktive të ISIS, kërcënojnë të gjithë ata që nuk besojnë tek Allahu në Shqipëri. Synimi është që të krijohet panik dhe stepje ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Ja çfarë thuhet në një prej këtyre videove: “Vallahi do të vijnë ditë të zeza për juve. Vallahi do të keni frikë të ecni nëpër rrugë. Do të keni frikë të punoni nëpër zyrat e juaja. Do të keni frikë e do të tmerroheni e të trishtoheni edhe në shtëpitë e juaja. Do të keni frikë e do të tmerroheni e të trishtoheni edhe në ëndrrat e juaja, edhe atëherë kur ju flini. Ne do t’ju mposhtim juve me lejen e Allahut. Do

---

<sup>101</sup> *Imamët e rekrutimeve në Siri, “blindohet” gjyqi*, Gazeta Panorama, 25 Nëntor 2015

<sup>102</sup> *“Vritini hebrenjtë në emër të Allahut”, imami “leksion” me thikë në dorë në xhami* Gazeta Tema, 12 tetor 2015

t'ju mbysim juve me lejen e Allahut. Do t'ju vijmë me eksplozivë"<sup>103</sup>.

Edhe në një video tjetër që gjendet aktualisht në You Tube, sërish paraqitet një xhihadist shqiptar i ISIS që bën thirrje "për të zhdukur, për të mposhtur, për të shtypur kufrin"<sup>104</sup> (jobesimtarin – shënim i autorit).

Në një reagim të ISIS ndaj disa ngjarjeve në Maqedoni, bëhet thirrje e hapur për luftë dhe terror. "Ora po vjen, shqiptarë gati për luftë! Prandaj shtrëngoni shuplakat, bashkohuni, bëhuni si një fortifikat dhe mos u frikësoni nëse vdisni me sukses! Prandaj terrorizoni kryqtarët dhe felëshuesit (tagutët dhe ndihmuesit e tyre) kudo që t'i zini! Prandaj kapni armët, kapni armët dhe luftoni deri në pikën e fundit të gjakut o kalorës të Hilafetit në Shqipni!" - shkruhet në mesazhin e ISIS dërguar në redaksinë e JavaNews.al

Siç shihet nga të gjithë shembujt e mësipërm, diskursi ekstrem që vjen kryesisht nga mediat online, paraqitet me të gjitha format e diskursit të dhunshëm: Si diskurs që legjitimon apo glorifikon përdorimin e dhunës ndaj ushtarakëve, por edhe ndaj civilëve që nuk besojnë tek Allahu. Si diskurs që glorifikon luftën e ISIS si dhe luftëtarët dhe martirët që vdesin për kauzën islamiste, me synim nxitjen e militantëve aktualë. Si diskurs në të cilin shfaqet edhe urrejtja ndaj grupeve apo komuniteteve të veçanta, si dhe thirrja për dhunë ndaj tyre, etj.

Edhe pse materialet që përmbajnë këtë diskurs nuk janë të shumta në numër, ato paraqesin një shkallë

---

<sup>103</sup> <http://www.telegrafi.com/lajme/ekskluzive-isis-ker-cenon-jobesimtare-ne-kosove-dhe-shqiperi-video-2-64670.html>

<sup>104</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=WCud3Nb8C2o>

rrezikshmërie të lartë, pasi mbjellin panik dhe stepje në publik dhe nga ana tjetër mund të motivojnë edhe individë të veçantë për t'u përfshirë në akte të tilla të dhunshme. Për këtë arsye një zgjidhje efektive nga ana e mediave, por edhe nga ana e organeve të sigurisë do të ishte deterrenizimi i mesazheve apo materialeve të tilla, në mënyrë që atyre t'u pritet rruga për të mbërritur te publiku shqiptar. Ndërkohë frytdhënës do të ishte edhe promovimi dhe përcjellja e mesazheve që denoncojnë qëllimet dhe pasojat e vërteta të propagandës ekstremiste të dhunshme.

## 7. Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij studimi ishte që të hulumtonte dhe të analizonte nga pikëpamja sasiore dhe cilësore diskursin ekstremist fetar në mediat shqiptare të shtypur dhe në ato online. Për të përmbushur këtë qëllim, fillimisht u pa e arsyeshme të paraqitej qasja konceptuale mbi të cilën do të bazohej studimi si dhe të përcaktohej një metodologji sa më efikase për kërkimin dhe analizën e ndërmarrë. Pas kësaj është hedhur një vështrim në linja të përgjithshme mbi kontekstin historik fetar në Shqipëri, me besimin se ndriçimi i këtij konteksti do të ndihmonte shumë për një kohezion sa më të plotë të studimit. Në këtë kuadër është gjykuar që të shqyrtohet edhe prania dhe shkalla e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit. Më pas është kaluar në analizën sasiore të diskursit ekstremist në mediat shqiptar, për të vijuar më tej me analizën sasiore të tij, ku shqyrtohen termat më specifike dhe më akute të këtij diskursi në rastin shqiptar.

Ndërmarrja e këtij studimi është ndikuar edhe nga disa zhvillime emergjente që kanë nxjerrë në pah



praninë në vend të njërës prej formave më shqetësuese të ekstremizmit aktualisht, siç është ekstremizmi islamist.

Në studim bëhet qartësisht dallimi mes ekstremizmit islamist si ideologji politike dhe Islamit si fe, duke argumentuar se Islami është një fe që ndiqet paqësisht dhe me devotshmëri nga mbi një miliard njerëz, kurse ekstremizmi islamist është një ideologji politike e mbështetur nga një minorancë. Në konceptin e këtij studimi, ekstremizmi islamist nuk është rrjedhojë e Islamit, por e keqinterpretimit dhe keqpërdorimit të tij për nevoja të interesave politike. Nga ana tjetër studimi i qëndron kursit se ekstremizmi islamist duhet të sfidohet dhe të përballohet, më shumë sesa të akomodohet apo të tolerohet nga demokracitë liberale.

Në analizën e vet për praninë dhe shkallën e përhapjes së ekstremizmit islamist në Shqipëri studimi arrin në përfundimin se ky ekstremizëm ka lindur si pasojë e depërtimit në vend të disa rrymave të huaja të Islamit sunit siç është salafizmi, i cili ofron një interpretim puritan dhe konservator të Islamit dhe paraqitet si një sfidë serioze ndaj shkollës liberale hanefi, që është feja e traditës për myslimanët sunitë shqiptarë. Deri në fund të viteve '90, ekstremizmi shfaqej kryesisht në ligjërimin radikal në disa xhami të vendit. Por zbulimi i aktivitetit të disa organizatave terroriste islamiste në vend si dhe raportimet për ekzistencën e mercenarizmit fetar islamist (në radhët e ISIS janë përfshirë rreth 140 shtetas të Shqipërisë) hodhën dritë mbi një anë tjetër të errët dhe të panjohur të problemit: atë të asociimit të aktivitetit fetar jo thjesht me radikalizmin por edhe me ekstremizmin e dhunshëm islamist.

Ndërkohë situata në hapësirën online, ku janë hapur me qindra websajte të shkollave të interpretimit ekstremist të Islamit, të krijon përshtypjen se përveç mercenarizmit të armës, po zhvillohet edhe mercenarizmi i fjalës. Si pasojë, nëse bombardimi i nxehtë mendohet si një rrezik potencial i largët për Shqipërinë, bombardimi i fjalës tashmë është duke ndodhur dhe vijon të intensifikohet nga dita në ditë.

Në qasjen e vet ndaj ekstremizmit, ky studim ka patur si pikë referimi modelin kushtetues liberal-demokratik të shoqërive perëndimore, të adoptuar tashmë edhe nga Shqipëria, si dhe sistemin specifik të vlerave të shoqërisë shqiptare, siç janë toleranca ndërfaqetare, përparësia e identitetit kombëtar ndaj identiteteve të tjera, respektimi i traditës, etj.

Nga pikëpamja metodologjike, për të minimizuar relativizmin dhe subjektivizmin gjatë punës për identifikimin dhe indeksimin e ekstremizmit, studimi është bazuar në instrumente dhe mekanizma metodologjike shkencore si Instrumenti i Monitorimit të Ekstremizmit EMI-20, apo Indeksi i Mediave Ekstremiste i propozuar nga Daniel Holbrook.

Pjesën më të madhe të tij studimi ia kushton hulumtimit e analizës së diskursit ekstremist në media. Diskursi normativ apo ai që konsiderohet “politikisht korrekt” nuk ishte pjesë e këtij studimi. Objekt i kërkimit ishin shtypi në Shqipëri dhe media online në gjuhën shqipe. Metodatat kryesore kërkimore-studimore ishin monitorimi dhe analiza e përmbajtjes. Por për nevoja të studimit u kryen edhe një grup intervistash me përfaqësues të komuniteteve fetare në vend apo me ekspertë të fushës.

Nga shtypi u përzgjedhën gazetat “Panorama”, “Shqip” dhe “Tema”, të cilat u monitoruan për një periudhë katërmujore nga 1 gushti deri në 30 nëntor 2015.

Monitorimi i mediave online përfshiu si websajtet mediatike edhe websajtet fetare institucionale apo individuale si dhe mediat sociale. Kërkimi online nuk ka qenë i lokalizuar territorialisht por i lokalizuar sipas gjuhës, pra në hapësirën online në gjuhën shqipe, edhe për faktin se mjaft websajte nuk deklarojnë vendin e themelimit apo të zhvillimit të veprimtarisë dhe shpesh nuk mund të ndahen websajtet e krijuara në Shqipëri nga ato të krijuara në Kosovë apo në vende të tjera.

Nga monitorimi i tre gazetave të përmendura më sipër si dhe i hapësirës online në gjuhën shqipe janë identifikuar një numër prej 284 materialesh që i përkasin të gjithë spektrit të indeksit ekstremist, duke nisur nga materialet e moderuara deri te materialet ekstreme. Një numër prej 201 materialesh janë identifikuar në median online kurse 83 janë identifikuar në shtyp.

Indeksi i lëndës së monitoruar, nxjerr në pah faktin që në mesin e materialeve të identifikuara, mbizotërojnë materialet që kanë përmbajtje të kategorisë “E moderuar”. Por në një numër relativisht të konsiderueshëm janë edhe materialet e kategorisë “Në zgrip” përmbajtja e të cilave nga pikëpamja fetare apo ideologjike paraqitet konservatore, izolacioniste dhe politikisht radikale dhe konfrontuese, por që nuk e përligj dhunën në skenaret aktuale.

Gjatë analizës sasiore të këtij studimi, në mediat e monitoruara janë ndeshur edhe materiale të kategorisë “Ekstreme”, por këto materiale nuk janë të shumta dhe shfaqen kryesisht në mediat online. Gjithsesi, edhe pse janë të pakta, ato përmbajnë miratim dhe glorifikim të

dhunës në kontekste bashkëkohore dhe dehumanizim të tjetrit.

Nga indeksimi total i të gjitha materialeve të identifikuara bie në sy se në rastin e shtypit, diskursi shkon deri te shkalla “Në zgrip” dhe nuk vihen re raste të diskursit “Ekstrem”. Ndërsa në mediat online, diskursi ekstremist arrin deri në nivelin “Ekstrem 3”.

Analiza cilësore e ndërmarrë në kuadër të këtij studimi u fokusua në termat kryesore të diskursit ekstremist të shfaqur në median e shtypur në Shqipëri dhe në mediat online në gjuhën shqipe.

Një nga termat e diskursit ekstremist fetar në mediat shqiptare ka qenë nënvlerësimi i identitetit kombëtar dhe nënshtrimi i tij ndaj identitetit fetar. Sfida më e hapur dhe më e rrezikshme ndaj identitetit kombëtar e shfaqur gjatë viteve të fundit është ajo që vjen nga diskursi ekstremist islamist, i paraqitur apo i raportuar edhe në media. Sipas interpretimit ekstremist salafist, identiteti fetar është mbi identitetin kombëtar. Duke përdorur kutin fetar për të përcaktuar njësinë kombëtare, synimi i diskursit islamist është të promovohet krijimi i një shoqërie në të cilën identiteti kombëtar duhet t’i nënshtrohet identitetit fetar. Por për një vend multifetar si Shqipëria kjo qasje cenon ekuilibrat jetikë të shoqërisë, mes të cilave dallohet përparësia e identitetit kombëtar mbi atë fetar, si dhe pluralizmi dhe sekularizmi i dëshiruar dhe i pranuar nga të gjithë.

Pre e diskursit ekstremist të mediave mediave ka rënë edhe toleranca fetare. Sfida ndaj tolerancës fetare paraqitet në forma të ndryshme, por forma më e pranishme në shkrimet e kësaj kategorie është ajo që ofron një “lexim tjetër për tjetër të tolerancës mes feve”. Në këtë optikë të

leximit të dukurisë, mbizotëron debati kontraversal, që merret me analizën e termave dhe faktorëve të supozuar dhe ngre pikëpyetje e dyshime, shpesh të panevojshme, lidhur me ekzistencën e tolerancës fetare në Shqipëri. Në kuadrin e këtij lloji “debati për debat” ka autorë që përpiqen të provojnë se një fakt real, si toleranca fetare, është thjesht një “mit i rremë”, “fasadë”, “thjeshtëzim i tepruar i historisë”, “artificë”, etj.

Por hapja në media e një debati që vë në dyshim tolerancën fetare në një kohë kur në vend, dhe në mbarë botën, bien kampanat e intolerancës dhe të dhunës ekstremiste, mund të konsiderohet edhe si një axhendë e gabuar në një moment të gabuar për median dhe për disa analistë në Shqipëri. E cila në mënyrë të tërthortë mund të favorizojë apo t'i japë argument edhe diskursit islamist të ekskluzivizmit fetar dhe të refuzimit të tolerancës e pluralizmit. Në paktin social shqiptar, toleranca fetare konsiderohet nga të gjithë si “e shenjtë” dhe jetike për të siguruar paqen sociale. Në të kundërt, intoleranca fetare mund të hedhë në erë vetë kombin dhe të ndezë në vend flakën e një lufte civile pa fund, siç ka ndodhur në ato vende ku ka mbizotëruar intoleranca fetare.

Diskursi ekstremist në media shfaqet edhe përmes termave të diskursit salafist që zhvillohet kryesisht në mediat online. Salafizmi është një lëvizje socio-politike që lindi në Egjipt në shekullin e 19-të në radhët e Islamit Sunit, e cila iu kundërvu integritit me shoqëritë kryesore europiano-perëndimore. Duke patur parasysh mënyrën e tyre fetare konservatore të jetesës, të gjithë salafistët mund të konsiderohen fundamentalistë, por jo të gjithë janë militantë të dhunshëm. Vetëm xhihadizmi salafist fokusohet në përdorimin e dhunës për të sjellë ndryshimin

shoqëror. Xhihadistët evokojnë përdorimin e dhunës për të krijuar një Kalifat të ri dhe për të fituar territoret që dikur kanë qenë sunduar nga myslimanët. Në ndjekje të mësimeve të tyre, xhihadistët refuzojnë pluralizmin fetar dhe aspirojnë sundimin e Islamit politik në të gjithë botën.

Pavarësisht nga ky profil i salafizmit, kjo rrymë teologjike ia doli të depërtojë në shoqërinë shqiptare dhe sot ne gjendemi përballë një fakti të kryer. Salafizmi sot ka objektet e veta të kultit (brenda apo jashtë kontrollit të KMSH), ka predikuesit e vet dhe mbështetet edhe nga një literaturë e gjerë offline dhe online në gjuhën shqipe. Sidomos në mjedisin online, infrastruktura paraqitet mëse e plotësuar ku gjenden shumë websajte që i kushtohen mësimit të fesë Islame sipas interpretimit të kësaj shkollë apo të shkollave të tjera të përafërta.

Termtat e diskursit salafist të shfaqura në mediat shqiptare janë tipike fundamentaliste, ku dallohet mes të tjerash intoleranca ndaj “jobesimtarëve” dhe optika përjashtuese dhe mohuese ndaj feve të tjera si dhe kërkohet që besimtarët të kthehen mbrapa te rregullat absolute dhe të pandryshueshme të themeluara në të shkuarën, duke lejuar vetëm një interpretim mes besimtarëve, dhe duke siguruar që rregullat fetare të mbizotërojnë mbi ato sekulare.

Në kuadër të diskursit ekstremist në media është shfaqur edhe debati: “Sheriati apo shteti ligjor i demokracisë liberale?” Edhe pse është periferik dhe i izoluar, debati pasqyron thellësinë e depërtimit të doktrinave islamiste në ato segmente të shoqërisë që janë të prekura prej tyre si dhe ndikimin e propagandës së ISIS në vend. Debati paraqitet si në plan teorik politik apo ideologjik, të zhvilluar kryesisht në websajtet fetare

online, edhe në plan konkret, si devizë apo pjesë e kredos dhe e veprimit praktik të islamistëve shqiptarë të lidhur me ekstremizmin e dhunshëm.

Në një plan më të përgjithshëm diskursi islamist propagandon “fundin e shtetit-komb dhe të demokracisë liberale” apo “krizën e modernizmit” nga njëra anë dhe “lindjen e një qytetërimi të ri islamik” nga ana tjetër. Në terma më specifikë në disa websajte fetare islamike shprehet refuzimi ndaj vlerave të demokracisë perëndimore, për shembull liria e fjalës apo të drejtat e njeriut.

Në debatin për të drejtat e njeriut islamistët refuzojnë si njohjen e të drejtave universale të njeriut edhe parimin e të drejtave të barabarta për të gjithë, veçanërisht për gratë. Gjithashtu në kundërvënje të hapur dhe të plotë me konceptin e lirisë dhe të të drejtave të njeriut që ekziston në shoqëritë perëndimore, paraqitet edhe trajtimi i grupeve të marginalizuara si ato LGBT nga ana e analistëve të websajteve islamiste.

Krahas debatit në plan teorik politik apo ideologjik, Sheriati paraqitet edhe si devizë apo pjesë e kredos dhe e veprimit të islamistëve shqiptarë të lidhur me ekstremizmin e dhunshëm. Kështu, një nga të arrestuarit e akuzuar për rekrutim në shërbim të ISIS, refuzon të gjykohet prej ligjeve të shtetit shqiptar dhe preferon të gjykohet vetëm nga ligjet e Allahut. Duke refuzuar plotësisht modelin e shtetit ligjor dhe të demokracisë liberale, ekstremistët islamistë propozojnë si alternativë Kalifatin duke e paraqitur atë si një projekt politik global që ka si qëllim final ndërtimin e të ashtu-quajturit “shtet i fundit”, apo “shtet i drejtësisë hyjnore”. Teza të tilla të Islamit Politik, nuk kanë qenë artikulluar ndonjëherë në gjuhën shqipe dhe nuk i janë servirur si alternativë

shqiptarëve gjatë gjithë ekzistencës së Islamit tradicional. Por rrymat e reja ekstremiste po i mbjellin dita-ditës ato. Shpalosja e këtyre tezave në kontekstet aktuale të luftës së ISIS e cila frymëzohet pikërisht nga ideja e krijimit të një shteti të drejtësisë hyjnore, është tepër e rrezikshme dhe një kërcënim serioz për shoqërinë shqiptare dhe të ardhmen europiane të saj.

Përsa i takon diskursit ekstremist antiperëndimor dhe antiamerikan, ai është i pranishëm jo vetëm në mediat online, por edhe në mainstream media. Ai ndjek disa forma, mes të cilave forma më e përdorur është ai lloj diskursi që shtron pyetjen: “Kush e shkakton terrorizmin” dhe që në përgjigje e gjen shkakun në anën e Perëndimit dhe të SHBA. Më së shumti në këtë lloj diskursi fajësohen ndërhyrjet ushtarake të Perëndimit në Lindjen e Mesme dhe Afganistan, si dhe politika e ndjekur nga ana e Perëndimit ndaj këtyre vendeve..

Për të përforcuar diskursin e tyre antiperëndimor dhe antiamerikan disa websajte fetare nuk rreshtin së përkthyeri edhe artikuj apo fjalime të autorëve apo liderëve nga Lindja e Mesme. Kështu në këto websajte u përkthye dhe u botua një thirrje e liderit suprem të Iranit Ajetullah Hamenei drejtuar të rinjve në vendet perëndimore pas akteve terroriste të nëntorit në Paris.

Në disa shkrime të tjera, vërehet një diskurs i përgjithshëm antiluftë, që në thelb është kundër ndërhyrjes ushtarake të Perëndimit në konfliktin e krijuar nga ISIS.

Siç del edhe nga monitorimi i kryer, shumica e diskursit antiperëndimor dhe antiamerikan gjendet në websajtet e fesë Islame, dhe në disa raste vihet edhe në shërbim të diskursit islamist.



Një grup tjetër shkrimesh në kuadër të diskursit antiperëndimor janë ato shkrime që botojnë apo trajtojnë supozime dhe teori konspiracioni lidhur me aktet terroriste apo me krijimin e ISIS. Dihet se prania në axhendën e medias e qasjeve konspirative nuk ndihmon në një informim të saktë të lexuesit, përkundrazi krijon edhe më shumë pështjellim tek ai, siç ka ndodhur edhe në rastin e shkrimeve të mësipërme, të cilat shpesh janë me burime të dyshimta apo të sajuaara.

Një tezë tjetër e ndeshur shpesh në diskursin ekstremist antiperëndimor është teza e standardeve të dyfishta. Sipas kësaj teze, shoqëritë dhe mediat perëndimore trajtojnë me standarde të dyfishta aktet terroriste që kryhen në Europë dhe ato në Lindjen e Mesme apo në vende të tjera joperëndimore të botës dhe “pikërisht ky standard i dyfishtë po e shkatërron botën.” Ndërkohë në disa nga mediat kryesore ofrohet një qasje tjetër opozitare ndaj tezës së standardeve të dyfishta.

Në format e veta më ekstreme, diskursi i mësipërm vihet në shërbim të nxitjes së urrejtjes antiperëndimore, antisemite apo antiamerikane.

Krahas diskursit teorik të moderuar apo që shkon deri në zgrip, në mjedisin online në gjuhën shqipe shfaqet herë pas here edhe diskursi që përlligj, glorifikon dhe promovon dhunën ekstreme, qoftë kjo e drejtuar ndaj trupave militare apo ndaj grupeve e komuniteteve të ndryshme jomilitare. Ky diskurs i shfaqur veçanërisht në vitet e fundit, edhe pse paraqitet i rrallë dhe i izoluar, rezonon shpesh me dhunën në kontekstet aktuale, siç është ajo që zhvillohet nga ISIS.

Burime të këtij diskursi kanë qenë kryesisht disa media online ose seksione të tyre të kontrolluara nga ISIS apo nga grupe të tjera ekstremiste islamiste. Por

shfaqje të diskursit në formën e denoncimit të tij vihen re edhe në raportimet e mediave për raste të ligjëriemeve ekstremiste të dhunshme nga ana e individëve islamistë apo ekstremistë.

Diskursi i kategorisë “Ekstrem” paraqitet me të gjitha format e diskursit të dhunshëm: Si diskurs që legjitimon apo glorifikon përdorimin e dhunës ndaj ushtarakëve, por edhe ndaj civilëve që nuk besojnë tek Allahu; Si diskurs që glorifikon luftën e ISIS si dhe luftëtarët dhe martirët që vdesin për kauzën islamiste, me synim nxitjen e militantëve aktualë; Si diskurs në të cilin shfaqet edhe urrejtja ndaj grupeve apo komuniteteve të veçanta si dhe thirrja për dhunë ndaj tyre, etj.

Edhe pse materialet që përmbajnë këtë diskurs nuk janë të shumta në numër, ato paraqesin një shkallë rrezikshmërie të lartë, pasi mbjellin panik dhe stepje në publik dhe nga ana tjetër mund të motivojnë edhe individë të veçantë për t’u përfshirë në akte të tilla të dhunshme. Për këtë arsye një zgjidhje efektive nga ana e mediave, por edhe nga ana e organeve të sigurisë do të ishte deterrenizimi i mesazheve apo materialeve të tilla, në mënyrë që atyre t’u pritet rruga për të mbërritur te publiku shqiptar. Ndërkohë frytdhënës do të ishte edhe promovimi dhe përcjellja e mesazheve që denoncojnë qëllimet dhe pasojat e vërteta të propagandës ekstremiste të dhunshme.

## Literatura

Bale , Jeffrey, *Denying the Link between Islamist Ideology and Jihadist Terrorism*, 2013

Bumçi, A. *Çështje të Sigurisë Kombëtare. Rasti i Shqipërisë. Kufiri, Feja Korrupsioni*. Tiranë: AIIS Press: (2004). f. 60. Cituar në: Hide,Enri, *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, AIIS, Tiranë, 2015

Coleman, Peter T. and Bartoli, Andrea, *Addressing Extremism*, White Paper. New York: The International Center for Cooperation and Conflict Resolution, Columbia University

Durham, Mary Edith, *The Burden of Balkans* , London, E. Arnold, 1905

Fiske, A.P. & Rai, R. S. *Virtuous Violence: Hurting and Killing to Create, Sustain, End and Honor Social Relationships*, Cambridge: CUP, 2015

Hide, Enri, *Lindja e një ndikimi të ri radikal dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri*, AIIS, Tiranë, 2015

Holbrook, Donald, *Designing and Applying an "Extremist Media Index"*, Perspectives on Terrorism Volume 9, Issue 5, 2015

Hussain, Ghaffar dhe Saltman, Erin Marie, *Jihad Trending: A Comprehensive Analysis of Online Extremism and How to Counter it*, Quilliam, May 2014

Kimball, Charles, *When Religion Becomes Evil: Five Warning Signs*, (New York: Harper, 2002), kapitujt 2-6 (The Five Warning Signs of Corruption in Religion).

Koopmans, Ruud, *Religious fundamentalism and hostility against out-groups: a comparison of Muslims and Christians in Western Europe*, në *Journal of Ethnic and Migration Studies* 41:1, 2014

Moroco dela Roka, Roberto, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, SHB Elena Gjika, Tiranë

Pamuk, O. (2005) *Istanbul: Memories and the City*, London: Faber & Faber

Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri, IDM, 2015

*Religious fundamentalism and radicalisation*, Parlamenti European, European Parliamentary Research Service, Autore: Anita Orav, Mars 2015

Schmid, Alex P., *Violent and Non-Violent Extremism: Two Sides of the Same Coin?*, ICCT Research Paper, May 2014

Vickers, Miranda, *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom, 2008

National Archives, Link:

<http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20130109092234/http://number10.gov.uk/news/pms-speech-at-munich-security-conference/>

CIA, Link: <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/al.html>

INSTAT, Link: [http://www.instat.gov.al/media/177354/main\\_results\\_population\\_and\\_housing\\_census\\_2011.pdf](http://www.instat.gov.al/media/177354/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf)

